

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6080  
E enjte, 6 gusht 2020  
çmimi 0.40 €

15 të vdekur  
dhe 218 raste të reja  
me Covid

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SEJDI HOXHA | FAQE 4-5

## QEVERTITË KANË DËSHTUAR T'U OFROJNË NDIHMË BIZNESEVE DHE QYTETARËVE

- PDK-ja, po të ishte e interesuar,  
tashmë do të ishte në pushtet

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, Sejdi Hoxha, ka thënë se qeveria Hoti ka dështuar t'i ndihmojë qytetarët dhe bizneset në këtë kohë të pandemisë. Ai ka thënë se vonesat për zbatimin e pakos emergjente fiskale janë duke ndodhur për shkak të mosdijes së koalicionit

qeverisë. "Me zvarritjen e kësaj pakoje, qeveria po tregohet e dobët, joprofesionale dhe shumë e vonuar për ofrimin e ndihmës për bizneset dhe qytetarët", ka thënë Hoxha. Ai ka theksuar se qeveria Hoti është dashur ta ndjekë shembullin e vendeve të ndryshme të cilat u kanë dalë në ndihmë bizneseve dhe qytetarëve, e jo

ta vazhdojë avazin e ish-qeverisë Kurti. Ndërsa për mundësinë e përfshirjes së PDK-së në qeverinë Hoti, Hoxha ka thënë se po të ishin të interesuar tashmë do të ishin në pushtet. "Deri më tani e kemi pasur mundësinë që të jemi parti në pushtet, por nuk kemi dashur", ka deklaruar Hoxha

## MBETET NË FUQI UDHËZIMI PËR RREGULLIMIN E ÇMIMEVE TË BARNAVE

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka anuluar vendimin e së martës me të cilin kishte shfuqizuar Udhëzimin Administrativ për rregullimin e çmimeve të barnave. Anulimi i këtij vendimi është bërë

pas presionit të opozitës, shoqërisë civile dhe Odës së Farmacistëve të Kosovës. Megjithatë, Ministria e Shëndetësisë ka mohuar se anulimi i vendimit është bërë për shkak të presionit publik



## NË KOSOVË PARALAJMËROHEN VËRSHIME, EKIPET EMERGJENTE BËHEN GATI

FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### OPINION

THAÇI DHE HARADINAJ, SIÇ  
KANË DITUR TA ÇLIROJNË  
KOSOVËN, DINË EDHE TA  
MBROJNË ATË (23) F. 11

Shkruan:  
Kudusi LAMA



### AKTUALE

HARADINAJ KTHEN  
50 DIPLOMATË, 30 TË TJERË  
I DËRGON NË MISIONE  
JASHTË VENDIT F. 6

OSMANI: ROLI I GJERMANISË  
PËR PERSPEKTIVËN EVROPIANE  
DHE EKONOMIKE TË KOSOVËS,  
KRUCIAL F. 2

### EKONOMI



HOTI KËRKON NGA DEPUTETËT  
TA MBËSHTESIN PROJEKTLIGJIN  
PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE F. 8

KOMISIONI HETIMOR PËR  
PRIVATIZIMIN MIRATON PLANIN  
E PUNËS, KËRKOHEH HETIM  
EDHE PËR SHPRONËSIMET F. 8

KËRKOHEH MBËSHTETJE  
FINANCIARE PËR PUNËTORËT  
TEKNIKË TË OKUK-SË  
DHE QMF-ve F. 9

## Libani në zi pas shpërthimit masiv që la mbi 100 persona të vdekur

BEJRUT, 5 GUSHT (ER) - Së paku 100 të persona të vdekur dhe më shumë se 4 000 të plagosur është bilanci i shpërthimit që ka ndodhur më 4 gusht në kryeqytetin e Libanit, Bejrut. I gjithë qyteti është tronditur nga shpërthimi, afër pjesës ku ndodhet porti. Incidenti shkaktoi dëme të shumta materiale, duke e bërë qytetin e Lindjes së Mesme të ngjante me një zonë të luftës.

Ministri i Shëndetësisë, Hamad Hassani, ka thënë se numri i viktimave pritet të rritet. Nuk është ende e qartë se çfarë e ka shkaktuar shpërthimin. Presidenti i Libanit, Michel Aoun, ka thënë se 2 750 tonë kimikate bujqësore ishin ruajtur në mënyrë të pasigurt në një depo për gjashtë vjet me radhë. Ndërsa zyrtarët libanezë kanë filluar një hetim për ta gjetur shkakun e saktë të shpërthimit. Këshilli i Lartë i Mbrojtjes në Liban ka thënë se ata që janë përgjegjës do të përballeshin me "dënimin maksimal" të mundshëm. Kurse presidenti

Aoun ka thënë se hetimi do t'i zbulojë rrethanat e asaj që ka ndodhur sa më shpejt të jetë e mundur dhe se rezultatet do të bëhen publike në mënyrë transparente. Në një fjalim televiziv në fillim të një mbledhjeje të kabinetit qeveritar, Aoun u ka bërë birrje kombeve të tjera ta shpejtojnë ndihmën për Libanin. Vendi do të jetë në zi kombëtare për tri ditë.

Më tutje, kreu i Kryqit të Kuq të Libanit, George Kettani, ka thënë se "ajo që ne po shohim është një katastrofë e madhe". Në rrjetet sociale qytetarët kanë postuar pamje të momentit të shpërthimit. Mediat kanë raportuar se kimikatet që kanë shpërthyer janë dërguar atje vite më parë nga një anije mallrash, që ishte konfiskuar, dhe e cila ishte në pronësi të biznesmenit rus Igor Grechushkin. Ai është një biznesmen nga qyteti siberian i Khabarovsk, por aktualisht jeton në Qipro.

Ndaj kësaj ngjarjeje të rëndë kanë reaguar liderë të ndryshëm



botërorë, në mesin e tyre edhe presidenti amerikan Donald Trump. Ai ka thënë se

shpërthimi masiv në Bejrut të Libanit mund të ketë qenë një sulm. "Duket si një sulm i

tmerrshëm", ka thënë Trumpi në një konferencë për media në Shtëpinë e Bardhë.

## Osmani: Roli i Gjermanisë për perspektivën evropiane dhe ekonomike të Kosovës, crucial



Prishtinë, 5 gusht (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, duke i uruar mirëseardhje dhe suksese në mandatin dhe detyrën e re. Në këtë takim janë vlerësuar lart raportet bilaterale në mes të Kosovës dhe Gjermanisë, si dhe ndihma që shteti gjerman ka dhënë për Kosovën në procesin e lirisë dhe shtetndërtimit. "U vlerësua

nevoja e vazhdimet dhe rritjes së bashkëpunimit institucional në nivelin, politik, ekonomik dhe diplomatik, si dhe shkëmbimi i përvojave në disa prej fushave specifike, siç është diplomacia parlamentare në mes të dy vendeve. Në lidhje me aktualitetin politik u diskutua angazhimi i institucioneve të vendit dhe përballja me gjendjen e rënduar nga pandemia si dhe nevoja që institucionet të kenë top prioritet adresimin e

çështjeve që ndërlidhen me pandeminë dhe gjendjen e rënduar ekonomike", ka njoftuar Kuvendi i Kosovës. Në raport me temën e dialogut, kryetarja Osmani ka theksuar se roli i Kuvendit në procesin e dialogut është crucial në raport me rritjen e transparencës dhe përmbylljes eventuale të një procesi të tillë. Po në këtë takim është diskutuar edhe avancimi i rolit të guas në proceset politike dhe shoqërore në vend.

## Meta dekreton katër ligje me një vërejtje për Kuvendin, Qeverinë dhe Ministrinë e Financave

TIRANË, 5 GUSHT - Presidenti Ilir Meta ka dekretuar katër ligje të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Meta ka dekretuar Ligjin nr. 96/2020 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", duke argumentuar se çdo nismë ligjore që synon realisht përafrimin e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe atij në fushën e transportit ajror në veçanti, në përputhje me acquis të Bashkimit Evropian, mirëpritet nga ai. "Shqipëria si shtet anëtar i ICAO-s (Organizata Ndërkombëtare

e Aviacionit Civil) dhe si aspirant për t'u asociuar në EASA (Agjencia e Bashkimit Evropian për Sigurinë në Operim të Aviacionit), ka detyrimin e përmirësimit të legjislacionit për përdorimin e hapësirës ajrore shqiptare në mbrojtje të sigurisë në fluturim dhe të të drejtave e interesave të pasagjerëve", ka thënë Meta.

Gjithashtu janë dekretuar Ligji nr. 108/2020 për një ndryshim në Ligjin nr. 87/2019 për faturën dhe sistemin e monitorimit të



qarkullimit, Ligji nr. 109/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 4/2020 për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare dhe Ligji nr. 110/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në

Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar. Përmes këtyre tri ligjeve shtohen afatet e fillimit të efekteve ligjore për vënien në funksionim të plotë të sistemit të ri të monitorimit të qarkullimit dhe afatet për raportim nga subjektet që kanë detyrim deklarim sipas kuadrit të ri ligjor.

Këto tri ndërrhyrje në ligjet ekzistuese janë dekretuar me shpallje, për ta respektuar nevojën e institucioneve,

njëkohësisht edhe të subjekteve për më shumë kohë, për t'u përshtatur infrastrukturës që kërkon regjimi i ri ligjor. Me këtë rast, Meta ka evidencuar se Ministria e Financave, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi, në ndërmarrjen e nismave dhe miratimin e ligjeve bazë, duhet të kishin vlerësuar më mirë të gjitha të dhënat faktike për përcaktimin e afateve kohore realiste, duke shmangur kështu nevojën e mendimeve të vazhdueshme të ligjeve të miratuara rishtazi.

Armend Zemaj anulon vendimin e së martës për rregullimin e çmimit të barnave

## Mbetet në fuqi udhëzimi për rregullimin e çmimeve të barnave

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka anuluar vendimin e së martës me të cilin kishte shfuqizuar Udhëzimin Administrativ për rregullimin e çmimeve të barnave. Anulimi i këtij vendimi është bërë pas presionit të opozitës, shoqërisë civile dhe Odës së Farmacistëve të Kosovës. Megjithatë, Ministria e Shëndetësisë ka mohuar se anulimi i vendimit është bërë për shkak të presionit publik



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 5 GUSHT-** Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka anuluar vendimin e së martës me të cilin kishte shfuqizuar Udhëzimin Administrativ për rregullimin e çmimeve të barnave. Pas një takimi me përfaqësues të Odës së Farmacistëve të Kosovës, të Shoqatës Farmaceutike të Kosovës, të Shoqatës së Distributorëve Farmaceutikë të Kosovës dhe zyrtarë të tjera nga komuniteti farmaceutik, Zemaj ka vendosur t'i kthehet udhëzimit administrativ të vjetër duke obliguar sekretarin e përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë që të ndërmarrë veprime për plotësim-ndryshimin e tij. "Në këtë takim, ministri Zemaj ka shpjeguar se anulimi i Udhëzimit Administrativ është bërë për shkak të pamundësisë së zbatimit të disa dispozitave të tij, të konstatuara nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave dhe nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë. Pas një diskutimi të gjatë rreth kësaj çështjeje, ministri Zemaj, me qëllim të gjetjes së zgjidhjes për zbatimin e këtij udhëzimi, i cili praktikisht ka

mbetur i pazbatuar që disa muaj, ka ofruar disa opsione për ta mundësuar vazhdimin e procesit dhe për ta bërë të zbatuar këtë udhëzim, në interes të rregullimit të tregut farmaceutik në Kosovë", është thënë në njoftimin për media të Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo ministri ka thënë se me shfuqizimin e Udhëzimit Administrativ nuk ka pasur tendencë që të krijojë mundësi për rritje të çmimeve të barnave. "Ministria e Shëndetësisë e ka bërë të qartë edhe në takimin e mbajtur me komunitetin farmaceutik, se vendimet e marra janë për shkak të pamundësisë së zbatimit të udhëzimit që do të plotësohet dhe kjo nuk ka të bëjë fare me interesa të tjera siç po provohet të interpretohet e keqpërdoret nga dikush. Interpretimet me ngjyrimet politike, pas vendimit të ministrit për, kinse, krijim të mundësive për rritje të çmimit të barnave, nuk kanë asnjë bazë dhe janë thjesht një tendencë për ta larguar vëmendjen nga fakti që udhëzimi i lartpërmendur, në formën si ishte, ishte i pazbatuar prej muajsh, për shkak të disa dispozitave që nuk i kishin adresuar drejt disa çështje që lidhen me çmimet e produkteve dhe

pajisjeve mjekësore", është thënë në njoftimin e ministrisë. Vendimi për shfuqizimin e udhëzuesit administrativ për rregullimin e çmimeve të barnave ishte kundërshtuar nga opozita dhe shoqëria civile. Ish-ministri i Shëndetësisë, Ura Ismaili, ka thënë se me veprimin e tij Zemaj i kishte dhënë mundësi korrupsionit në shëndetësi. "Ministri Armend Zemaj dje u ka dhënë hapësirë krimin dhe korrupsionit në shëndetësi, duke e shfuqizuar Udhëzimin Administrativ për rregullimin dhe unifikimin e çmimit të barnave. Me këtë vendim ai ka goditur një nga reformat më të mëdha në historinë e shëndetësisë dhe ka rilegalizuar krimin", ka thënë ai, duke shtuar se anulimi i këtij vendimi ka ndodhur për shkak të presionit të madh. "Pas presionit publik, Zemaj ka

shfuqizuar sot vendimin e djeshëm, duke krijuar një ekip të ri për ta ndryshuar këtë Udhëzim, i cili ishte hartuar me ekspertë ndërkombëtarë dhe nën mbikëqyrjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë", është shprehur ai. Edhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka kundërshtuar vendimin e ministrit të Shëndetësisë për shfuqizimin e Udhëzimit Administrativ të rregullimit të çmimeve të barnave. "Bazuar në raporte të ndryshme të cilat tregojnë për rritje enorme të çmimeve dhe ngrehin shqetësime rreth sinjeritetit afarist në këtë sektor, si në aspektin e blerjeve publike, po ashtu edhe në atë privat, konsiderojmë se shfuqizimi i këtij Udhëzuesi Administrativ pa masa të tjera të gatshme për parandalimin e keqpërdorimeve me barna

është i dëmshëm për qytetarin, tashmë edhe më të varfëruar si pasojë e pandemisë", ka vlerësuar KID-ja, duke shtuar se Udhëzuesi Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve mjekësore kishte për qëllim t'i përcaktonte dhe rregullonte çmimet e produkteve mjekësore për shitje me shumicë dhe pakicë në sektorin privat. "Shfuqizimi i këtij udhëzuesi do të lejojë që qytetarët përsëri të blejnë barna të njëjta me çmime të ndryshme në barnatore si dhe qeveria t'i pranojë ofertat nga operatorët ekonomikë me çmime të larta. Kosova është ndër shtetet e pakta në Evropë që nuk e ka të rregulluar tregun farmaceutik", është thënë në reagimin e KDI-së. Ndërsa Oda e Farmacistëve e Kosovës shfuqizimin e udhëzimit e kishte quajtur akt kriminal.

## MSh-ja do të financojë shkollimin e kandidatëve të ardhur nga Lugina



**PRISHTINË, 5 GUSHT -** Ministria e Shëndetësisë do ta financojë shkollimin e kandidatëve të ardhur nga Lugina e Preshevës. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se këto quadro pastaj do të kthehen të shërbejnë si staf profesional shëndetësor në Komunën e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. Në profilin e vet në

"Facebook", Zemaj ka shkruar se mbështetja për shqiptarët e Luginës së Preshevës nuk do të mungojë asnjëherë. "Mbështetja për bashkëqytetarët tanë në Luginën e Preshevës nuk do të mungojë asnjëherë! Në kuadër të kësaj mbështetjeje, qytetarëve të Luginës u është siguruar një kuotë e veçantë për shkollim specialistik. Ministria e Shëndetësisë do ta

financojë shkollimin e kandidatëve të ardhur nga Lugina, quadro të cilat do të kthehen të shërbejnë si staf profesional shëndetësor në Komunën e Preshevës, të Medvegjës dhe në atë të Bujanocit! Përfaqësuesit e Luginës i sigurova që kujdesi dhe mbështetja ime për bashkëqytetarët tanë atje do të vazhdojë", ka shkruar Zemaj.

Flet për "Epokën e re", Sejdi Hoxha

# Qeveritë kanë dështuar t'u ofrojnë

## - PDK-ja, po të ishte e interesuar, tashmë do të ishte në pushtet

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës, Sejdi Hoxha, ka thënë se qeveria Hoti ka dështuar t'i ndihmojë qytetarët dhe bizneset në këtë kohë të pandemisë. Ai ka thënë se vonesat për zbatimin e pakos emergjente fiskale janë duke ndodhur për shkak të mosdijes së koalicionit qeverisës. "Me zvarritjen e kësaj pakoje, qeveria po tregohet e dobët, joprofesionale dhe shumë e vonuar për ofrimin e ndihmës për bizneset dhe qytetarët", ka thënë Hoxha. Ai ka theksuar se qeveria Hoti është dashur ta ndjekë shembullin e vendeve të ndryshme të cilat u kanë dalë në ndihmë bizneseve dhe qytetarëve, e jo ta vazhdojë avazin e ish-qeverisë Kurti. Ndërsa për mundësinë e përfshirjes së PDK-së në qeverinë Hoti, Hoxha ka thënë se po të ishin të interesuar tashmë do të ishin në pushtet. "Deri më tani e kemi pasur mundësinë që të jemi parti në pushtet, por nuk kemi dashur", ka deklaruar Hoxha

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 5 GUSHT** - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Sejdi Hoxha, ka vlerësuar se qeveria e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti ka dështuar t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe bizneseve në kohën kur vendi ynë është duke u ballafaquar me pandeminë Covid-19. Në këtë intervistë dhënë "Epokës së re", Hoxha ka thënë se qeveria Hoti është duke e vazhduar rrugën e dështimit të cilën e kishte nisur ish-qeveria e drejtuar nga Albin Kurti. "Të njëjtin dështim e ka edhe qeveria Hoti, pasi për më shumë se gjashtë muaj s'ka arritur ta impletojë një pako të vetme fiskale, e cila si pikë kryesore ka dhënien e 170 eurove për punëtorët e sektorit privat dhe pagesën e qerasë për 50 për qind për bizneset. Karshi vendeve të rajonit, Kosova është vonuar më së shumti për zbatimin e pakos fiskale. Qeveria apo kryeministrat, ato para nuk kanë pasur t'i japin nga buxheti familjar, pasi ka ekzistuar buxheti shtetëror, mirëpo si pasojë e mosdijes dhe zvarritjes së këtij procesi, ende bizneset dhe qytetarët s'i kanë marrë pagesat e dyta", është shprehur Hoxha, duke e quajtur joprofesionale qeverinë Hoti.

Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës do të duhej ta ndiqte shembullin e shumë vendeve evropiane të cilat kanë reaguar me urgjencë karshi pandemisë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se gjatë gjithë kësaj kohe grupi parlamentar i PDK-së ka qenë konstruktiv sa i përket

menaxhimit të situatës në të cilën gjendet vendi. Hoxha ka thënë se për hir të interesit të qytetarëve, PDK-ja, edhe pse në opozitë, ka mbështetur buxhetin e rishikuar edhe pse, sipas tij, ky buxhet është me plot defekte. "PDK-ja ishte e gatshme ta japë kontributin në mënyrë që pandemia të ketë ndikim sa më të vogël në jetën e qytetarëve por, fatkeqësisht, kjo pako nuk ka gjetur përkrahje nga partitë e atëhershme në pozitë", është shprehur Hoxha.

Hoxha, i cili është edhe anëtar i komisionit hetimor parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë, ka folur edhe për punën e këtij komisioni. "Për vitet të tëra janë hedhur akuza të ndryshme ndaj PDK-së sa i përket procesit të privatizimit. Për ta dëshmuar të kundërtën dhe për t'i hedhë dritë këtij procesi, kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, e ka iniciuar një hetim parlamentar nga Kuvendi", ka thënë Hoxha.

Ndërsa duke folur për mundësinë e përfshirjes së PDK-së në qeverinë Hoti, Hoxha ka thënë se po të ishin të interesuar tashmë do të ishin në pushtet. "Deri më tani e kemi pasur mundësinë që të jemi parti në pushtet, por nuk kemi dashur", ka deklaruar Hoxha.

Sa iu përket raportimeve në media për mundësinë e përfshirjes së PDK-së në qeverinë Hoti, Hoxha ka thënë se nuk janë të interesuar për një gjë të tillë. "Deri më tani e kemi pasur mundësinë që të jemi parti në pushtet, por nuk kemi dashur. Ne kemi dashur

që të reflektojmë si parti opozitare dhe të dëshmojmë që jemi për shtetin dhe qytetarët edhe pse jemi në opozitë", ka deklaruar Hoxha.

**"Epoka e re": Z. Hoxha, si e vlerësoni situatën ekonomike në kohën e pandemisë, marrë parasysh proceset legjislative nëpër të cilat kanë kaluar disa ligje nga fusha ekonomike?**

**Hoxha:** Kriza globale që ka shkaktuar pandemia ka ndikuar negativisht në të gjithë botën, jo vetëm në aspektin shëndetësor, por ka goditur rëndë edhe ekonominë më të zhvilluar të botës. Në këtë aspekt e ka goditur jashtëzakonisht shumë edhe Kosovën. Unë jam një ndër deputetët më të zëshëm që kam folur për ndihmën që qeveria duhet t'ua japë bizneseve dhe qytetarëve në kohën e pandemisë. Ky problem zanafillën e ka nga aprovimi i Ligjit të buxhetit nga ish-qeveria Kurti, kur në mënyrë klandestine, në mesnatë dhe pa debat me opozitën, e kanë aprovuar këtë ligj, duke u thirrur në situatën e pandemisë, ndërsa nuk kishin paraparë mjete financiare me të cilat do ta menaxhonin situatën. Këtë e dëshmon edhe fakti që ish-qeveria Kurti nuk ka mundur ta implementojë pakon fiskale që e ka aprovuar vetë. Thënë më shkurt, ata kanë aprovuar pako për të cilat s'i kanë pasur mjetet financiare. Të njëjtin dështim e ka edhe qeveria Hoti, pasi për më shumë se gjashtë muaj s'ka arritur ta zbatojë një pako të vetme fiskale, e cila si pikë kryesore ka dhënien e 170



eurove për punëtorët e sektorit privat dhe pagesën e qerasë për 50 për qind për bizneset. Karshi vendeve të rajonit, Kosova është vonuar më së shumti në implementimin e pakos fiskale. Qeveria apo kryeministrat, ato para nuk kanë pasur t'i japin nga buxheti familjar, pasi ka ekzistuar buxheti shtetëror, mirëpo si pasojë e mosdijes dhe zvarritjes së këtij procesi, ende bizneset dhe qytetarët s'i kanë marrë pagesat e dyta.

**"Epoka e re": Propozimi i PDK-së ishte që punëtorët e sektorit privat të marrin nga 300 euro për tre muaj, por ky propozim ishte quajtur "ambicioz" dhe i paarrtshëm. Marrë parasysh mundësitë buxhetore, mendoni se do të mund të realizohej një propozim i tillë?**

**"Epoka e re":** Pakoja fiskale e aprovuar në ish-qeverinë Kurti-Hoti në vlerë prej 170 eurosh ne e kemi konsideruar se është asistencë sociale, e jo ndihmë për punëtorët e sektorit privat. PDK-ja, edhe pse në opozitë, e ka përgatitur dhe modeluar një pako fiskale në kuptimin financiar dhe është prezantuar nga shefi ynë i grupit parlamentar, Bedri Hamza. Kjo pako ka qenë mjaft serioze dhe do ta ndihmonte shumë

sektorin privat. PDK-ja ishte e gatshme që të japë kontributin në mënyrë që pandemia të ketë ndikim sa më të vogël në jetën e qytetarëve por, fatkeqësisht, kjo pako nuk ka gjetur përkrahje nga partitë e atëhershme në pozitë. Ne edhe pse jemi në opozitë, kemi luajtur rol konstruktiv në çdo vendim që ka ardhur në Kuvend, i cili prek interesat e qytetarëve. Më lejoni t'i jap dy shembuj. I pari ka të bëjë me votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në vlera milionëshe për projekte të ndryshme, ku ne kemi votuar pro tyre përkundër faktit që LDK-ja dhe LV-ja sa ishin në opozitë s'e kanë bërë një gjë të tillë. Ne kemi dashur të japim shembull se edhe pse jemi në opozitë, ne jemi pro interesit të vendit. Dhe shembulli i dytë ka të bëjë me Ligjin për buxhetin e rishikuar, ku edhe pse kemi pasur shumë vërejtje, pasi është një dokument joprofessional dhe nuk i zgjedh problemet e vendit, ne kemi votuar pro tij dhe për hir të situatës. Ky projektligj nuk kishte asnjë shans të kalonte pa votat e PDK-së. Por, edhe këtë çështje e kemi tejkaluar për hir të interesave të qytetarëve.

# ndihmë bizneseve dhe qytetarëve



**“Epoka e re”:** A kishte “rezistencë” brenda grupit tuaj parlamentar që mos të votohej buxheti i rishikuar?

**Hoxha:** Të them të drejtën secili nga deputetët, bazuar në situatën në të cilën gjendet vendi, nuk ka ngurruar të votojë. Ne kemi pasur raste kur së bashku me grupin ishim në dreka dhe kafe dhe vinin kamerierët dhe pronarët e restoranteve dhe na lusnin që ta votojmë buxhetin dhe t’i harrojmë dallimet politike, duke vendosur në interes të bizneseve dhe qytetarëve. Pra, brenda grupit kishte një unitet të përgjithshëm për këtë. Por, pavarësisht prej gatishmërisë sonë, me zvarritjen e kësaj pakoje qeveria po tregohet e dobët, joprofesionale dhe shumë e vonuar për ofrimin e ndihmës për bizneset dhe qytetarët.

**“Epoka e re”:** Pandemisë s’i dihet fundi, kurse ekspertët e ekonomisë paralajmërojnë kolaps financiar nëse deri në tetor nuk ofrohet ndihmë më e madhe për bizneset nga shteti. Sipas jush, si duhet të ndihet dora e shtetit tani e tutje?

**Hoxha:** Qeveria e Kosovës duhet t’i përcjellë vendet evropiane në aspektin

ekonomik. Unë kam shikuar strategjinë e shumë vendeve dhe kemi rastin e Austrisë e cila ka ndarë 38 miliardë euro për t’i ndihmuar qytetarët dhe bizneset. Kemi rastin e Mbretërisë së Bashkuar që ka ndarë 2 500 puandë për çdo punëtor të sektorit privat. Po ashtu, kemi rastin kur shtete të ndryshme kanë paguar punëtorët me orar të shkurtuar, shembull bizneset e gastronomisë që punojnë me orar të shkurtuar.

**“Epoka e re”:** Z. Hoxha, cili do të jetë epilogu i komisionit hetimor parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë dhe si u përgjigjeni zërave që “ky komision është iniciuar për ta “pastruar” PDK-në?

**Hoxha:** Për vite të tëra janë hedhur akuza të ndryshme ndaj PDK-së sa i përket procesit të privatizimit dhe për ta dëshmuar të kundërtën dhe për t’i hedhur dritë këtij procesi, kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, e ka iniciuar një hetim parlamentar nga Kuvendi në mënyrë që të hetohet komplet procesi i privatizimit nga koha e AKM-së dhe transformimi në AKP. Pra, të hetohen të gjitha privatizimet dhe të shihet kush

kanë qenë privatizuesit dhe lidhjet e tyre direkte apo indirekte me politikën. Po ashtu, të analizohet se a janë përmbushur kontratat në mes të AKP-së dhe privatizuesve. Të gjitha këto procese i kemi iniciuar dhe kemi filluar grumbullimin e informacioneve nga AKP-ja, ku kemi marrë listën dhe të gjitha raportet do të jenë publike. Mandati i këtij komisioni është gjashtë muaj dhe, marr parasysh faktin që kanë ndodhur mijëra privatizime, nuk është e lehtë që ky proces të përfundojë shpejt, pasi është shumë kompleks dhe duhen analiza mjaft të mëdha.

**“Epoka e re”:** Meqë ishit në krye të Postës e që është pranë kolapsit, çfarë strategjie duhet të përdoret dhe a jeni pro privatizimit të Telekomit të Kosovës?

**Hoxha:** Në Postën e Kosovës mandatin e kisha trashëguar me rreth 3 milionë humbje financiare në vitin 2012. Ndërsa për herë të parë në historinë e saj ka përformuar në formë pozitive në vitin 2016, duke dalë me bilanc pozitiv. Po përmend vetëm një shërbim që e kishim krijuar e që është shërbimi i kryerjes së pagesave në zyrat

postare, ku sot Posta e Kosovës ka 2 milionë euro të hyra vjetore nga ky shërbim. Kemi edhe shërbimin tjetër të krijuar për herë të parë, siç është shpërndarja e skemave sociale. Ju e dini se në kohën e pandemisë brenda dite posta ka shpërndarë të gjitha asistencat në tërë territorin e Kosovës. Ka mënyra sesi qeveria mund ta ndihmojë këtë ndërmarrje, siç është mbulimi i shërbimit universal postar. Ju e dini që posta për 0.40 centë e dërgon një letër kudo në Kosovë, madje edhe në zonat me të thella, për shembull, në Dragash, dhe kjo i kushton postës rreth 40 euro, por duhet ta dërgojë pasi e ka obligim ligjor. Në të gjitha vendet e botës ky shërbim subvencionohet, pasi për postën ky shërbim krijon më shumë humbje sesa fitim. Në bazë të kalkulimeve që kanë ekzistuar, humbja financiare është rreth një milion në vit nga ky shërbim. Qeveria duhet të jetë e vëmendshme që ta subvencionojë këtë shërbim. Aspekti tjetër është kalimi i disa shërbimeve shtetërore te posta, siç i kanë vendet e rajonit.

**“Epoka e re”:** Çfarë shërbimesh?

**Hoxha:** Për shembull, bartjen e

aplikimeve të dokumentacioneve të ndryshme, bartjen e dokumenteve zyrtare siç janë pasaportat dhe dokumentet e tjera. Pastaj kryerja e disa pagesave shtetërore janë një varg shërbimesh që qeveria e vendit mund t’i kalojë te Posta e Kosovës. Sa i përket Telekomit, mendoj se qeveria duhet të vijë me një strategji konkrete se si ta nxjerrë nga kriza financiare. Telekomit kishte disa probleme në të kaluarën, si ndalja e investimeve kapitale në fazën kur teknologjia avanconte, pastaj ka pasur moskujdes në shpenzimet operative, shpenzimet e marketingut dhe të tjera. Të gjitha këto kanë bërë që të futet në krizë të thellë financiare. Mendoj se qeveria shumë shpejt do të vijë me një plan konkret dhe punëtorët që punojnë aty ta vërejnë sa më pak këtë çështje.

**“Epoka e re”:** Z. Hoxha, ka zëra që edhe PDK-ja do të bëhet pjesë e qeverisë Hoti. A është diskutuar kjo çështje brenda strukturave të PDK-së pasi ju jeni edhe kryetar i degës së kësaj partie në Drenas?

**Hoxha:** PDK-ja që nga shpallja e zgjedhjeve ka dhënë shembullin më të mirë në rajon dhe Evropë. Ju e keni parë Veselin, i cili ende pa u shpallur rezultatet ka dalë në konferencë për media dhe e ka pranuar humbjen. Ky qëndrim i liderit është përshëndetur nga të gjithë, duke përfshirë edhe shoqërinë civile. Deri më tani e kemi pasur mundësinë që të jemi parti në pushtet, por nuk kemi dashur. Ne kemi dashur që të reflektojmë si parti opozitare dhe të dëshmojmë që jemi për shtetin dhe qytetarët edhe pse jemi në opozitë. Në kuadër të pyetjes së shtruar ju, ne e kemi parë në media një lajm të tillë, por nuk është temë që është diskutuar në grupin parlamentar. Kjo temë më shumë është çështje që është përfolur në media dhe nga analistë politikë.

**“Epoka e re”:** Nga këndvështrimi juaj, a duhet të ketë zgjedhje në këtë kohë?

**Hoxha:** Jemi në një situatë të rëndë pandemike me të cilën Kosova është kapluar më shumë se çdo vend tjetër në rajon. Qëndrimi ynë ishte edhe atëherë se, po të mos ishte pandemia, ne do të duhej të shkonim në zgjedhje të jashtëzakonshme, pasi mendojmë se qeveria aktuale dhe ajo e kaluar janë treguar të paafta për t’u përballur me situatën e krijuar.

## Haradinaj kthen 50 diplomatë, 30 të tjerë i dërgon në misione jashtë vendit

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Ministri e Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, i ka kthyer 50 anëtarë të personelit diplomatik dhe konsullor që kanë përfunduar mandatin e rregullt katërvjeçar dhe atyre që për tetë vjet nuk janë kthyer asnjëherë. Po ashtu, kryediplomatja ka emëruar që të shërbejnë në misionet e Kosovës më shumë se 30 anëtarë të Shërbimit të Jashtëm, zyrtarë të karrierës, të cilëve për më shumë se 11 vjet nuk u është dhënë mundësia për të shërbyer jashtë vendit. Këto vendime Haradinaj-Stublla ka thënë se i ka marrë në kuadër të konceptit "një në shërbim, një në ministri". "Për herë të parë, pas 12 vjetësh të funksionimit të shërbimit të jashtëm, në pajtim të plotë me dispozitat përkatëse ligjore, kemi realizuar caktimin në detyra në formë të rotacionit të rregullt për personelin diplomatik dhe konsullor, sipas konceptit 'një në shërbim, një në ministri'. Për qëllimet e lartcekura do të kthehen nga misionet që të shërbejnë në ministri, më shumë se 50 (pesëdhjetë) anëtarë të personelit diplomatik dhe konsullor, të cilët kanë përfunduar mandatin e rregullt katërvjeçar dhe nga ata të cilët, për më shumë se tetë vjet pa



shkëputje nuk janë kthyer asnjëherë për të shërbyer në ministri", ka thënë ajo. Haradinaj-Stublla ka theksuar se caktimet në detyra specifike në misionet jashtë vendit, në nivelet e rangut përkatës janë bazuar në nevojat e shërbimit dhe gatishmërinë e secilit që të shërbejë në ministri ose kudo

jashtë vendit sipas nevojave të brendshme në zbatim të rregullores për shërbimin e jashtëm. "Bazuar në kompetencat ligjore dhe rekomandimet e përcjella nga paneli i brendshëm për shprehje të interesit kam emëruar që të shërbejnë në misionet e Republikës së Kosovës më

shumë se 30 (tridhjetë) anëtarë të shërbimit të jashtëm, nga të cilët, zyrtarë të cilëve për më shumë se 11 vjet nuk u është dhënë mundësia për të shërbyer jashtë vendit, profesionistë me përvojë në fushat përkatëse, që do t'i ushtrojnë funksionet në çështjet diplomatike dhe konsullore dhe nga të cilët

kërkohej që të ushtrojnë me ndershmëri dhe korrektësi funksionet dhe detyrat e ngarkuara, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, aktet ndërkombëtare dhe me legjislacionin e Republikës së Kosovës", është shprehur Haradinaj-Stublla.

## Në Kosovë paralajmërohen vërshime, ekipet emergjente bëhen gati



PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka thënë se për shkak të reshjeve të shiut, që të mërkurën nisën me intensitet të lartë, në disa zona mund të ketë vërshime. Reshjet e shiut do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, ka njoftuar IHMK-ja. "Nëpër rrjedhat kryesore lumore do të ketë ngritje të lehtë të niveleve gjatë ditëve në vijim, ndërsa rrjedhat me karakter malor dhe ato të rrëmbyeshme do të paraqesin mundësi të vërshimeve të shpejta dhe vështirësi nëpër zonat/vendbanimet ku ato kalojnë", është thënë në njoftimin e këtij instituti. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka theksuar se pas paralajmërimeve për

vërshime të mundshme, ekipet emergjente kanë rritur shkallën e gatishmërisë për të intervenuar. "Sipas Institutit Hidrometeorologjik, mund të priten vërshime nga të reshurat e shumta. Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave së bashku me FSK-në do të jenë në gatishmëri për të intervenuar sipas nevojave që paraqiten nga komunat. Sapo i njoftuam kryetarët e komunave se dy ministrat, Veliu dhe Quni, janë angazhuar tanimë", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook". Të mërkurën në Kosovë që në orët e hershme të mëngjesit ka pasur reshje të vazhdueshme të shiut, të cilat në Prishtinë dhe disa qendra të tjera të Kosovës kanë bërë që disa rrugë të përmyten.

## Shefi i EULEX-it: Sundimi i ligjit duhet të jetë i të gjithëve

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Shefi i EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark, është deklaruar rreth sistemit të drejtësisë në Kosovë. Me këtë rast, ai ka

thënë se sundimi i ligjit duhet të ndërtohet nga poshtë dhe të jetë i të gjithëve, jo vetëm i disave. "Sundimi i ligjit duhet të ndërtohet nga poshtë dhe

të jetë i të gjithëve, jo vetëm i disa prej tyre. Krenar për punën tonë me organizatën e shoqërisë civile IKD, për angazhimin e qytetarëve të

zakonshëm të Kosovës si 'monitorues' të gjyqësorit të Kosovës", ka shkruar Wigemark në llogarinë e vet në "Twitter".



Rritet numri i personave të vdekur nga koronavirusi në Kosovë

# 15 të vdekur dhe 218 raste të reja me Covid

Është rritur numri i vdekjeve me Covid-19 në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se 15 pacientë me Covid kanë vdekur gjatë 24 orëve të fundit, se janë regjistruar 218 raste të reja, kurse 156 pacientë janë shëruar. Këto shifra dalin pas testimit të 461 të mostrave nga IKShPK-ja. Ndërsa Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka treguar se në spitalet e Kosovës janë duke u trajtuar 432 persona të konfirmuar me Covid-19



## Katërbëdhjetë pacientë me Covid-19 të vendosur në respiratorë

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka bërë me dije se në klinikat e QKUK-së dhe në spitalet rajonale po trajtohen 432 persona të konfirmuar me Covid-19. Sipas këtyre të dhënave, krahasuar me një ditë më parë, katër pacientë më shumë janë të shtrirë në spitalet e klinikave, ku po trajtohen për koronavirus. Sipas njoftimit, 237 pacientë janë të shtrirë në klinikat e Qendrës Klinike Universitare dhe 195 në spitalet rajonale. Prej tyre, 14 pacientë janë në gjendje më të rënduar dhe janë të vendosur në respiratorë. Ndërkaq, 35 pacientë po trajtohen me makinën për frymëmarrje me maskë, e njohur me shkurtesën CPAP, ndërkaq 389 po trajtohen me oksigjenoterapi.

strikte të respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura", ka bërë me dije instituti.

**EPOKA  
ERE** **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 5 gusht** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë 15 persona si pasojë e Covid-19 dhe janë paraqitur 218 raste të reja. Instituti ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shënuar 218 raste të reja me Covid, ndërsa 156 pacientë janë shëruar. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 461 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 218 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 9.492 raste nga 38 803 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 284 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 156

pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 5 346 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 862", është thënë në njoftimin e IKShPK-së. Numrin më të madh të të infektuarve vazhdon ta ketë


Prishtina, me gjithsej 70 raste të reja. Pastaj vijnë komuna e Podujevës 23 raste, komuna e Gjilanit 16 raste, komuna e Ferizajt 15 raste, komuna e Fushë Kosovës 12 raste, komuna e Pejës 12 raste, komuna e Lipjanit 7 raste,

komuna e Prizrenit 7 raste, komuna e Suharekës 7 raste, komuna e Drenasit 6 raste, komuna e Skenderajt 6 raste, komuna e Gjakovës 5 raste, komuna e Malishevës 5 raste, komuna e Dragashit 4 raste, komuna e Mitrovicës 4 raste, komuna e Deçanit 3 raste, komuna e Istogut 3 raste, komuna e Shtimes 3 raste, komuna e Kamenicës 2 raste, komuna e Rahovecit 2 raste, komuna e Vitisë 2 raste dhe me nga një rast komunat Kaçanik, Klinë, Klokot dhe Vushtrri. Instituti u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që të kenë kujdes dhe t'u përmbahen rekomandimeve të institucioneve shëndetësore. "Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obligative! Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë

## Deputetja Kadaj-Bujupi bashkë me dy fëmijët dalin pozitivë me Covid

Deputetja e AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, ka njoftuar se, pas analizave të bëra, ka dalë pozitiv me Covid-19, bashkë me të dy fëmijët. "Dje kam rezultuar pozitiv në testin për Covid-19. Njëjtë sikur unë, edhe dy fëmijët e mi, Dardani e Doruntina. Prej se e kemi marrë testin jemi vetëizoluar dhe do të qëndrojmë kështu duke respektuar rekomandimet e IKShPK-së, të cilin i falënderoj për punën e pandalshme e të palodhshme. Është momenti ta ruajmë njëri-tjetrin, duke ndjekur veç tre hapa: mbajtje të maskës, mbajtje të distancës dhe mbajtje të higjienës personale", ka shkruar ajo në profilin e vet në "Facebook".

## Në shtator, përballje më sfiduese me Covid-19



**PRISHTINË, 5 GUSHT** - Kosova është duke u përgatitur për krijimin e kapaciteteve shtesë për përballjen me Covid-19 në muajin shtator atëherë kur, sipas profesionistëve shëndetësorë, Kosova do të përballet edhe me virusin sezonal dhe eventualisht mund të ketë rritje të numrit të raste me koronavirus. Për këtë arsye janë duke u bërë përgatitje për funksionalizimin e një spitali të përkohshëm me deri 500 shtretër. Mikrobiologu në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, Lul Raka, ka deklaruar për "Radion Evropa e Lirë" se

përballja me Covid-19, sëmundjen që e shkakton koronavirusi, do të jetë edhe më e vështirë në shtator kur shfaqet edhe gripi sezonal dhe kur temperaturat fillojnë të bien. "Në shtator kur kemi gripin sezonal, kur fillon ftohja e motit dhe kur një pjesë e madhe e njerëzve qëndrojnë brenda nëpër lokale, kjo besoj se do ta vështirësojë edhe më shumë përballjen me virusin. Do të kemi dy viruse përballë - koronavirusin dhe virusin sezonal", ka deklaruar Raka. Ai ka shtuar se me paraqitjen e gripit sezonal gjendja do të jetë më sfiduese për Kosovën. Gripi

sezonal është një infeksion akut viral. Transmetohet direkt nga një person i sëmurë te tjetri përmes spërklave gjatë kollitjes ose teshtitjes dhe në mënyrë indirekte me prekjën e objekteve të kontaminuara me virusin e gripit sezonal. Dallimi mes koronavirusit dhe viruseve sezonale, sipas profesionistëve shëndetësorë, është se koronavirusi i ri është më i ashpër se viruset sezonale, pikërisht për shkak të përhapjes së shpejtë që ka. Ndërkaq, sa iu përket simptomave, ka ngjashmëri, si: ethe, temperaturë, dhimbje fyti, të vjella, diarre, kokëdhimbje etj.

# Hoti kërkon nga deputetët ta mbështesin Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) – Komisioni për Buxhet dhe Transfere, me kërkesë të nënkryetarit të parë të këtij komisioni, Gazmend Abrashi, ka mbajtur mbledhje online, në të cilën është diskutuar rreth Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike Covid-19. Nënkryetari Abrashi, i cili edhe e ka udhëhequr këtë mbledhje, e ka arsyetuar rëndësinë e mbajtjes së saj, duke thënë se dërgimi në seancë plenare i këtij projektligji është i rëndësishëm për qytetarët në këtë kohë pandemie. Pas votimit për shmangie nga rregullorja, para anëtarëve të Komisionit, projektligjin e ka prezantuar ministrja e Financave dhe Transfereve, Hykmete Bajrami. Sipas saj, qëllimi i Projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike- Covid 19, nëpër-



mjet të cilit bëhet plotësimi dhe ndryshimi i disa ligjeve, është rimëkëmbja e ekonomisë së Republikës së Kosovës, pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Ligji për Fondet Pensionale të

Kosovës, Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe Ligji për

Agjencinë Kosovare të Privatizimit, janë ligjet të cilët pritet të ndryshohen nëpërmjet këtij projektligji. Pas mbledhjes së këtij komisioni, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka kërkuar nga deputetët që ta mbështesin Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike. “Po krijohen kushtet për zbatim të plotë të pakos për rimëkëmbje ekonomike. Sot në Komisionin për Buxhet dhe Financa është miratuar dhe përcjell për seancë Projektligji për rimëkëmbje ekonomike. I falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit për mbështetje. I lus të gjithë deputetët që ta mbështesin këtë projektligji në seancë, në mënyrë që të miratohet para se Kuvendi të shkojë në pushim veror. Programi për rimëkëmbje ekonomike

financohet nga tri burime: (1) mjetet nga buxheti i rregullt; (2) marrëveshjet ndërkom-bëtare; dhe (3) Ligji për rimëkëmbje ekonomike. Dy të parat tanimë janë miratuar, për të cilët u jam falënderues të gjithë deputetëve”, ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në “Facebook”. Në këtë kontekst, Hoti ka thënë se janë në rrugë të sigurimit të mjeteve për rimëkëmbjen ekonomike. “Me buxhetin e vitit 2021 do të zhvillohen masa të tjera dhe do të vazhdojnë disa prej masave ekzistuese, si dhe do të identifikohen instrumente financiare shtesë për ta mbështetur rimëkëmbjen ekonomike. “Jemi në rrugë të mbarë për ta mobilizuar shumën prej 1.2 miliard eurosh për rimëkëmbje ekonomike”, ka shkruar kryeministri Hoti.

## Bordi i shkarkuar i KEK-ut e vlerëson të padrejtë vendimin e qeverisë Hoti

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Anëtarët e bordit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), të cilët janë shkarkuar të martën nga qeveria Hoti, e kanë quajtur të padrejtë një vendim të tillë. Ata kanë vlerësuar se gjatë periudhës menaxhuese të tyre kanë arritur të vendosin rregull në KEK. “Dje kemi pranuar informatën se është bërë shkarkimi ynë nga qeveria Hoti, me arsyetimin se nuk e kemi përfillur rekomandimin e Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, e cila përfaqëson Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit për pezullimin e procedurave të rekrutimit të pozitave të larta në ndërmarrjet publike, kinse deri në zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar me Ambasadën e Britanisë për asistencë në përzgjedhje meri-



tore të pozitave të larta dhe udhëheqëse në Ndërmarrje

Publike. Fillimisht, ju lutem na lejoni t’ju informojmë që ne

Bordi i përkohshëm i Korporatës Energjetike të Kosovës e kemi marrë këtë detyrë nga qeveria Kurti, më datë 23.04.2020. Pranimi i kësaj detyre ishte një obligim dhe përgjegjësi për ne duke pasur parasysh rëndësinë e korporatës për vendin, si dhe situatën e krijuar në korporatë nga parregullsitë dhe shkeljet e adresuara nga kjo qeveri, bazuar edhe në gjetjet e auditorit. Për periudhën 103-ditëshe kemi pasur nderin ta mbështesim dhe ndihmojmë punën e vyer të profesionistëve dhe punëtorëve/eve në dobi të KEK-ut. Kjo periudhë, edhe pse jo e gjatë dhe aspak e lehtë, së bashku me menaxhmentin dhe punëtorët/et, ne ia dolëm që të marrim vendime që ia kthejnë menaxhmentit në KEK integritetin dhe qeverisjen e mirë, si dhe trans-

parencë dhe llogaridhënie”, është thënë në reagimin e anëtarëve të Bordit të shkarkuar të KEK-ut, duke numëruar një varg vendimesh të cilat janë marrë në funksion të përmirësimit të gjendjes në këtë ndërmarrje. “Bazuar në këtë, konstatimet e qeverisë Hoti të cilat janë marrë për arsyetim nuk janë fare të qëndrueshme. Në referimin e devijuar të Ligjit për Ndërmarrje Publike ka qenë e vetmja mundësi për të formuluar një paragraf për shkarkim - ‘pa arsyetim’. Gjithashtu, ju lutem na lejoni t’ju rikujtojmë që këto pozita të larta në periudha të mëparshme janë përzgjedhur me prani të monitoruesve, por vendimet e tyre kanë qenë në dëm të korporatës dhe shkeljet e parregullsitë kanë qenë të njëpasnjëshme”, është thënë në këtë reagim.

## Kërkohet mbështetje financiare për punëtorët teknikë të OKUK-së dhe QMF-ve

Prishtinë, 5 gusht (ER) - Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat e Kosovës (SPSPK) ka kërkuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami dhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, që të të gjithë punëtorëve teknikë që punojnë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) dhe në Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) t’u vazhdohet mbështetja financiare. “Punëtorët e

sektorit privat në përgjithësi janë në gjendje të rëndë, duke u nisur nga mosimplementimi i Ligjit të punës, marrëveshje kolektive dhe ligjet e tjera që kanë të bëjnë me pozitën e punëtorëve të këtij sektori, si dhe duke u nisur nga moslëvizja e pagës minimale për 10 vjet rresht. Mirëpo në këtë situatë pandemie Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat e Kosovës kërkon që të gjithë punëtorëve teknikë që punojnë në Qendrën Klinike

Universitare të Kosovës dhe në qendrat e mjekësisë familjare, më hollësisht punëtorëve të higjienës dhe punëtorëve të sigurimit fizik, t’u vazhdohet mbështetja financiare edhe për muajt qershor dhe korrik me nga 300 euro pasi kjo kategori e punëtorëve është e rrezikuar nga pandemia Covid-19 kur dihet se këta punëtorë janë të parët që ballafaqohen me pacientët e infektuar”, është thënë në reagimin e SPSPK-së.





# Komisioni hetimor për privatizimin miraton planin e punës, kërkohet hetim edhe për shpronësimet

Komisioni hetimor parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë ka mbajtur mbledhjen e radhës dhe ka miratuar planin e punës. Në këtë mbledhje anëtarët e këtij komisioni nga radhët e Vetëvendosjes kanë kërkuar që në kuadër të këtij komisioni të hetohen edhe shpronësimet që kanë ndodhur në Kosovë, kurse ata të PDK-së nuk janë pajtuar me një gjë të tillë, duke insistuar që për këtë çështje të themelohet një komision i veçantë

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Komisioni hetimor parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë, i kryesuar nga Hajrulla Çeku, kryetar, ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, në të cilën është diskutuar rreth ndryshimeve të fundit të planit të punës së këtij komisioni. Kryetari Çeku ka theksuar se „ashtu siç janë pajtuar në mbledhjen e fundit, në këtë plan të punës tashmë janë inkorporuar të gjitha sugjerimet dhe rekomandimet lidhur me punën e këtij komisioni. Pas diskutimeve, komisioni, me shumicën e votave, i ka dhënë

mbështetje planit të propozuar. Para se të miratohet ky plan, deputeti i Vetëvendosjes, Liburn Aliu, ka propozuar që ky komision të merret edhe me hetimin e shpronësimeve. “Kemi shpronësuar me çmime shumë të larta, por edhe me çmime shumë të ulëta”, ka thënë Aliu.

Ndërsa deputeti i PDK-së, Sejdi Hoxha, ka kërkuar që të themelohet një komision i veçantë për hetimin e shpronësimeve. Sipas tij, komisionin për privatizimin nuk ka kompetenca që të merret edhe me shpronësimet. “Nuk po më pëlqen që po kthehem në pikën zero. Mundemi me nis edhe një

komision për shpronësime, sepse ky proces nuk lidhet me shpronësimet”, është shprehur ai.

Me një konstatim të tillë nuk është pajtuar deputeti tjetër i Vetëvendosjes, Hekuran Murati, i cili ka thënë se nuk ka asnjë ndërhyrje në fushëveprimtarinë e komisionit nëse hetohen edhe shpronësimet. “Nuk shoh që kemi problem me këtë fushëveprim. Nëse shkojmë me

këtë fushëveprim jemi në rregull, duhet me marrë informata prej të gjitha palëve”, është shprehur Murati, ndaj të cilit ka reaguar deputeti Hoxha. “Ne nuk po fshehim asgjë. Mos u mundoni të devijoni. Ju po thoni është 1 për qind. Ku po e dimë për sa raste duhen lëshuar shpronësimet. Pse mos t’i bëjmë krejt në këtë komision?! T’i hetojmë krejt shpronësimet”, ka thënë Murati.

Më tutje, deputetja e LDK-së,

Doruntinë Maloku, ka thënë se pozicioni i deputetëve të PDK-së dhe LV-së është duke krijuar përshtypjen e bllokimit të punëve. Krejt në fund kryetari i këtij komisioni, Hajrulla Çeku, ka kërkuar që deri në fund të javës të jetë gati lista e dëshmitarëve dhe ekspertëve në lidhje me këtë proces. “Deri në fund të javës të dërgohet lista e dëshmitarëve. Edhe për ekspertët duhet të vendosim deri në fund të javës”, është shprehur Çeku.

## Gjykata Komerçiale shihet si shtyllë e fortë për sistemin e drejtësisë

PRISHTINË, 5 GUSHT - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe USAID - Programin për Drejtësi Komerçiale, kanë mbajtur të mërkurën një forum virtual për të diskutuar në lidhje me krijimin e Gjykatës Komerçiale e cila do ta ndihmonte ekonominë tash në epokën e Covid-19, por edhe në komplikimet e tjera ekonomike që ka Kosova.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka theksuar se krijimi i kësaj gjykate do ta rregullonte ekonominë e vendit, posaçërisht për rimëkëmbjen ekonomike. Ai ka thënë se Gjykata Komerçiale, ndër të tjera, do të krijonte ambient më të besueshëm dhe do të sillte më shumë investime në Kosovë. “Gjykata do të ndihmonte në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të besueshme. Rrit besimin e bizneseve në institucione. E zvogëlon perceptimin e



korupsionit dhe e rrit profesionalizmin”, ka thënë Rukiqi.

Ndërsa ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka thënë se ka qenë e rëndësishme që së bashku me partnerët strategjikë të fillohet puna për krijimin e një ndërmarrje me të madhe siç është Gjykata Komerçiale, e cila do të merret me kontestet

ekonomike. Ai ka thënë se themelimi i kësaj gjykate do të jetë shtyllë e fortë e sistemit të drejtësisë dhe nuk e ngarkon atë siç është parë me skepticizëm. “Artikuli në një shtyllë i çështjeve komerciale i zgjidhë ato me ekspertizë, ulë riskun e të bërit biznes, riskun e kontesteve, riskun e fitimit sepse mbrohet me një gjykatë e cila merret

ekskluzivisht me këtë çështje. Kërkesa ime specifike për grupin punues ka qenë që të bëhet një panel i veçantë i cili do të merret vetëm me investimet direkte të huaja ngaqë ka vullnet nga investitorët e huaj për të investuar në Kosovë meqë plotësohen shumë kushte ekonomike, përfshirë fuqinë punëtore, politikat e favorshme

të taksave, pozita gjeografike, infrastruktura. Po ashtu, kam vërejtur se kontestet që ndodhin gjatë të bërit biznes tejzgjatjen nëpër gjykata. Prandaj është e domosdoshme që të kemi një panel brenda gjykatës, i cili merret vetëm me investime direkte të huaja e kjo njëherësh do ta përçonte mesazhin se Kosova është e favorshme për të investuar, por edhe i mbron këto investime”, ka thënë Selimi, duke shtuar se në shtator pritet që ligji për krijimin e kësaj gjykate të shkojë në Kuvend. “E kam prioritet që gjykata të formohet sa më shpejt. Kah shtatori do ta kemi ligjin gati mbi Gjykatën Komerçiale dhe do ta procedojmë në Kuvend dhe besoj se nuk do të kontestohet”, ka theksuar Selimi. Në anën tjetër, gjyqtari Mahir Huduti ka sqaruar se struktura e Gjykatës Komerçiale do ta mundësojë operimin me profilizim të caktuar të gjyqtarëve.

## Haziri mbështet kërkesat e transportuesve privatë

GJILAN, 5 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim pune përfaqësuesit e transportuesve privatë, me të cilët ka bashkëbiseduar për respektimin e masave anti-Covid dhe për mundësinë e krijimit të kushteve më të mira për operim në kushte pandemie. Haziri ka thënë se gjendja në të cilën ndodhet Gjilani dhe hapat që ka ndërmarrë për respektimin e masave mbrojtëse konform vendimit të qeverisë dhe institucioneve të shtetit është rënduese për një kategori të gjerë në sektorin privat, mirëpo shëndeti publik është parësor dhe duhet të respektohen ato. "Komuna e

Gjilanit është vazhdimisht e përkushtuar për mbështetje të sektorit privat dhe të transportuesve. Është gjendja e tillë që kujdesi duhet të jetë maksimal për të qenë shëndeti publik stabil dhe nën kontroll. Jemi pajtuar për respektimin e marrëveshjes që është bërë me Stacionin e Autobusëve dhe bashkërisht do të jemi në çdo kohë që ta menaxhojmë në mënyrën më të mirë këtë gjendje deri në normalizim të plotë. Unë jam pranë tyre dhe i mbështes kërkesat, sepse kështu mund të rrezikohet edhe stacioni si ndërmarrje, por edhe transportuesit privatë, gjithashtu. Do të ecim përpara me kujdes në mënyrë që dëmi të jetë sa më i vogël",



ka thënë Haziri. Ndërsa në emër të transportuesve privatë kanë folur Jakup Berisha dhe

Rexhep Sejdiu, të cilët kanë falënderuar kryetarin Haziri për angazhimin dhe janë

zotuar se transportuesit do të jenë bashkëpunues me komunën.

## Komuna e Mitrovicës prezanton draftplanin e mobilitetit të qëndrueshëm urban

MITROVICË, 5 GUSHT (ER) - Në Sallën e Kuvendit Komunal të mërkurën është bërë shpaloja e Draftplanit të mobilitetit të qëndrueshëm urban të Komunës së Mitrovicës Jugore për vitet 2020-2028, hartuar nga UN-Habitat-i dhe Komuna e Mitrovicës, në bazë të udhëzuesit evropian për mobilitet. Në këtë prezantim ishte i pranishëm nënkryetari i kësaj komune, Faruk Mujka, drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, përfaqësuesja nga UN-Habitat-i, Zana Sokoli, zyrtarë të tjerë komunalë si dhe përfaqësues nga shoqëria



civile. Me këtë rast, nënkryetari Mujka ka thënë se Mitrovica po bëhet me planin e mobilitetit, pas një procesi gjithëpërfshirës dyvjeçar të hartimit të tij nga UN-Habitat dhe Komuna e Mitrovicës. "Ky plan parasheh zgjidhje afatgjatë për komunën tonë në raport me transportin regional dhe Mitrovicën si qendër e regjionit verior të Kosovës, transportin publik dikur ekzistues në Mitrovicë, parkingjet si një ndër problemet më të mëdha të qendrave tona urbane, hapësirat publike, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta. Pas

këtij diskutimi plani do të vihet në shqyrtim publik online për qytetarët, në mënyrë që t'i japin komentet e tyre finale para se të aprovohet në asamblenë komunale", ka thënë Mujka. Ndërsa përfaqësuesja nga UN-Habitat-it, Zana Sokoli, ka prezantuar para të pranishmëve në detaje gjithë planin e hartuar, për të vazhduar më pastaj me gjetjet dhe propozimet e tjera nga ana e të pranishmëve. Në fund, Sokoli e ka dorëzuar këtë plan të kryetari Agim Bahtiri, i cili e ka përgëzuar për punën e kryer me sukses nga grupi punues i komunës dhe UN-Habitat-it.

## Rregullohen tri rrugë në Carrallukë të Malishevës

MALISHEVË, 5 GUSHT (ER) - Kanë filluar dhe janë duke vazhduar punimet për rregullimin e tri segmenteve rrugore në fshatin Carrallukë të Komunës së Malishevës. Këto rrugë janë duke u ndërtuar në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në këtë komunë. Punimet në këto tri segmente rrugore të mërkurën i kanë parë nga afër kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, së bashku me zëvendësministrin në

Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Enver Hoti, drejtorin e Urbanizimit, Ahmet Morina dhe drejtorin e Shëndetësisë, Liridon Hoti, të cilët janë pritur nga kryetari i fshatit Carrallukë, Rrustem Hoti. Kryetari Begaj dhe zëvendësministr Hoti kanë uruar banorët dhe fshatin Carrallukë për ndërtimin e këtyre rrugëve, të cilat kanë rëndësi të madhe për banorët. Ndërsa drejtori i Urbanizimit,

Ahmet Morina, i ka njoftuar të pranishmit me projektin dhe ka sqaruar se këto rrugë rregullohen në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, ku dy segmente financohen nga kjo ministri dhe një segment nga Komuna e Malishevës. Në anën tjetër, kryetari i fshatit, Rrustem Hoti, i ka falënderuar Komunën e Malishevës dhe Ministrinë e Infrastrukturës për ndërtimin e këtyre rrugëve në fshatin Carrallukë.



## Lipjani mbyll sheshin, parqet, shtigjet e ecjeve dhe tregjet

LIPJAN, 5 GUSHT (ER) - Komuna e Lipjanit ka njoftuar se për shkak të situatës së krijuar nga rastet e fundit me Covid-19 në këtë komunë, është marrë vendim që të

mbyllet përkohësisht sheshi "Adem Jashari", parqet, shtigjet e ecjeve, këndet e lojërave dhe tregjet. Me këtë rast, kjo komunë ka kërkuar nga bizneset që t'u përmba-

hen në tërësi kriterëve dhe rekomandimeve për distancë në mënyrë që të parandalohet përhapja e virusit Korona. "Për zbatimin e këtij vendimi obligohet

inspektorati komunal në bashkëpunim me Policinë e Kosovës", është thënë në njoftimin e Komunës së Lipjanit. Që nga fillimi i pandemisë e deri tash janë kon-

firmuar 232 raste me koronavirus në këtë komunë dhe janë regjistruar pesë raste të vdekjeve. Aktualisht në Lipjan janë 117 raste aktive me këtë sëmundje.

# THAÇI DHE HARADINAJ, SIÇ KANË DITUR TA ÇLIROJNË KOSOVËN, DINË EDHE TA MBROJNË ATË (23)



Shkruan: Kudsi LAMA

Ndoshta shumëkujt do t'i duken të tepërta e të panevojshme shumë citime që janë vendosur në këtë analizë reaguese. Do të ketë shumë të drejtë se edhe unë gjatë punës me këtë material kam shumë momente që më duken të panevojshme disa citime, por i kam vënë në renditje të rrjedhës, sepse qëllimi im është të bëj që lexuesit të kuptojë se ku i ka marrë Dick Marty të dhënat për raportin e tij, që e ka dëmtuar mjaft imazhin shqiptar në opinionin e gjerë ndërkombëtar. Të kuptojnë lexuesit se ky zotëri nuk është tjetër veçse një zë i Serbisë në dritaret e Evropës, për ta nxirë imazhin shqiptar.

Dhe sa shumë lidhje ka sipas Serbisë e zotit Marty, Hashim Thaçi me Drenicën, na jepet në të dyja këto materiale identike, për ta vërtetuar në radhë të parë për vete, por edhe për opinionin "rrezikshmërinë" që ky grup paska për Ballkanin dhe Evropën. Me thënë të drejtën, mua që ndihem plotësisht njohës i zhvillimeve të luftës e pasluftës, nuk më duket se ky lloj kriminaliteti qëndron. Unë mund të kem pretendime për qeverisje edhe më të mirë prej Hashim Thaçit e bashkëpunësorëve të tij, por që ai dhe gjithë ata që qeverisin Kosovën sot, të punojnë për ta kriminalizuar vendin e tyre, më duket absurde dhe e papranueshme. Sepse kjo do të ishte sikur ta ndërtohet një shtëpi të bukur për vete dhe pastaj t'i veshë zjarrin. Besoj se nuk ka shqiptar të paktën që të besojë se djemtë që zhvilluan luftën duke bërë sakrificat më të larta për hatër të atdheut, të përpiqen sot ta djegin atë.

Por ja që gjendet dikush, i cili përpiqet të na e njollojë luftën dhe paqen e shqiptarëve. E të tillë që gjenden në Serbi shqiptarët e dinë, por që të gjenden edhe në Evropë na duket një kundërvënie qëllimkeqe.

"Në territorin e komunave të Pejës, Deçanit dhe Gjakovës, që gjenden në zonën e Dukagjinit, vepron i ashtuquajtur grupi i Metohisë të cilin e udhëheq Ramush Haradinaj. Familja Haradinaj është e orientuar në tregtinë ilegale me armët, drogën, mallrat akcizë, me automjetet e vjedhura, etj. Malli kontrabandë shpërndahet në Maqedoni, në jug të Serbisë, në zonën e Rashkës dhe në Mal të Zi, duke shfrytëzuar drejtimin rrugor Pejë - Kulla - Rozhajë. Duke pasur parasysh

lidhjet e afërta të Ramush Haradinajt me luftëtarët e ish-UÇK-së, të cilët, pas çmilitarizimit të saj, kaluan në radhët e K3K-së., dhe të Shërbimit të Policisë së Kosovës, është në gjendje të realizoj tërthorazi kontrollin mbi kufirin e zonave të përmendura si dhe me veprimtaritë kriminale dhe terroristike në këtë terren".<sup>1</sup> Ramush Haradinaj dy herë si rrjedhojë e këtyre akuzave shpifëse u dorëzua për gjykim në Gjykatën për Krime Luftë në Hagë. Të dy herët e fitoi luftën përballë akuzave të ngritura kundër tij. Dy herë Ramush Haradinaj e mundi Serbinë atje në mes të Evropës. Dy herë u kthye kryelartë si një luftëtar i devotshëm në atdheun e tij. Pse zotëri Marty nuk e vlerëson këtë akt, por e paragjykon edhe atë e edhe aktin e fitores dy herë të Fatmir Limës? Por mjaftohet duke thënë se gjykimi nuk është arritur të bëhet si duhet? Siç duket zotëri Marty, sipas instruksioneve të Serbisë, e di mirë atë tregimin popullor, që: "Një kriminel i cili nuk kishte lënë të keqe pa bërë kundër njerëzve që kishte përreth kur i afrohet vdekja i mbledhë këta njerëz që ishin kryesisht bashkëfshatarët e tij dhe u thotë: E kuptoj që në jetën time u kam bërë shumë të këqija, prandaj do t'u lë amanet që të më ndëshkoni pas vdekjes. Për ndëshkim dua që kur të më varrosni, të më lidhni një litar në qafë e ta lini pjesën e litarit jashtë varrit, që secili ta dijë se pas vdekjes time e keni marrë hakun. Dhe fshatarët pasi vdes kriminelin, kur shkojnë për ta varrosur, sipas amanetit, me të drejtë të Zotit, i lidhin litarin në fyt dhe pjesën zgjatuese të litarit e lënë jashtë mbi tokë. Ndodh që ato ditë andej kalon një repart kalorësie dhe kali i një ushtari ngatërrohet në litarin e varrit të kriminelit e rrëzohet. Ndalon repartit dhe shikojnë litarin, gërmojnë varrin dhe shikojnë se litar ishte lidhur në qafën e të vdekurit. Krijojnë bindje se dikush e kishte mbytur dhe varrosur me gjithë litar. Mbledhin gjithë fshatin dhe fillojnë t'i torturojnë për të treguar se kush e ka mbytur të vdekurin. E në këtë moment njëri thotë: Mirë që na nxu jetën sa ishte gjallë, por po na dërmon kockat me dru edhe i vdekur". Pra, prej kësaj kuptoj se kriminelin edhe në grahmat e fundit mendon si mund të bëjë krim edhe pasi të ketë vdekur. Jam i sigurt se Serbia këtë synim ka pasur dhe ka në gjithë veprimtarinë e saj të djeshme dhe të sotme, por ja që gjeti edhe një Dick Marty që u bë bisht i saj. "Në zonën e Llapit, duke përfshirë komunat e Gjilanit, Vitinit dhe Kaçanikut, vepron grupi besnik i Rustem Mustafës, të quajtur "Remi" njëri prej komandantëve më me ndikim të UÇK dhe K3K.

Ky klan është i orientuar në veprimtaritë e lidhura për kontrabandën e drogës dhe është në lidhje të ngushtë me familjen Haradinaj".<sup>2</sup> Është për të vlerësuar që nuk është lënë kuadër i lartë i drejtimit të luftës çlirimtare të Kosovës që nuk është përgojuar si drogmen, trafikant, kriminel, terrorist etj., duke tentuar t'i njolloset të gjithë. Të krijohet ideja që këta djem që bënë luftën nuk paskan pasur tjetër qëllim vetëm të kryenin vepra të tilla. Po pse duhet të kryenin vepra të tilla këta duke u vënë përballë forcave ushtarako-policore serbe e duke luftuar kundër tyre? A nuk ishte më e lehtë të merreshin me këto lloj krimesh pa qenë të përballur me forcat e pushtuesit e, ndoshta, duke punuar bashkë me ta, siç edhe ka momente kur njerëz të ndryshëm të kombësisë shqiptare kanë bashkëpunuar me serbët e me Serbinë edhe për këto rrugë?

Por jam i bindur se synimi nuk është që të thuhet diçka që qëndron, qëllimi është të hidhet baltë mbi gjithçka që kombi shqiptar e konsideron të çmuar, që opinionin të "kuptojë e bindet" se shqiptarët atë që e kanë më të shenjtë e kanë kriminale dhe prej kësaj rrjedhë arsyetimi se me shqiptarët mund të kuptohesh vetëm duke i shtypur, duke i masakruar, duke i varur dhe duke i mbajtur të shtypur e në skllavëri. Familja Lluka është e lidhur me mafinë shqiptare dhe merret me kontrabandën e armëve, të drogës dhe me mallra akcize (cigare, benzinë), vepron nën mbulimin e Hashim Thaçit dhe të Ramush Haradinajt dhe të mafies shqiptare.<sup>3</sup>

Është i pa pranueshëm fakti që gjithkund nëpër Kosovë na qenkan të lidhur Hashim Thaçi dhe Ramush Haradinaj. Ata siç duket e paskan çliruar Kosovën për ta bërë vend të krimit. A nuk kanë pasur mundësi kur kanë gjithë këtë fuqi që e deklaroi Serbia, që pikërisht Serbinë ta kishin kriminalizuar? A nuk paska pasur mundësi familja Lluka me gjithë atë fuqi ekonomike që

bashkë me këta dy njerëzit që vërtetë janë të fuqishëm por jo për krime, nëse do të ishin të tillë ta shtrinin fushën e veprimit në Serbi e ta kriminalizonin në të gjithë hapësirën e saj?

Ky lloj arsytimi mua më duket sikur të ndodhte një rast kur: një njeri pasi ndërton një shtëpi për vete, e kthen atë në çerdhe minjsh. A ka mundësi që i zoti i shtëpisë ta kthejë shtëpinë e tij në çerdhe minjsh? Shqiptarët nuk e imagjinojnë një gjë të tillë, ndoshta serbët dhe zoti Marty po. Duhet ditur se Hashim Thaçi dhe Ramush Haradinaj, po të ishin të tillë që të aktivizonin mafie, pa tjetër që do ta aktivizonin në Serbi. Edhe unë po të kisha një ambicie të tillë këtë do të kisha bërë, por kurrë ndër familjarët e mi e ndër shqiptarët, ashtu sikur edhe ata kurrë dhe për asnjë arsye nuk do ta kthenin Kosovën në terren mafieje. Por ne nuk mendojmë e veprojmë si serbët, ndaj edhe nuk na shkon në mendje të bëjmë akuza të tilla as për ta. Megjithatë mirë është që të përfitojmë nga kjo përvojë e "vyer" serbe e të fillojmë të shpifim edhe ne ashtu sipas përvojës që serbët e kanë shumë të sofistikuar. Por jam i sigurt se ne nuk kemi nevojë të shpifim, ne kemi nevojë vetëm të evidencojmë me besnikëri ato që serbët kanë bërë në trojet shqiptare, në Kosovë e mbi shqiptarët për një shekull, ato është mirë t'i evidencojë edhe zotëri Marty, sa merret me shpifje kundërshqiptare. I shkreti, s'ka ç'bën, është me shërbim, pasi paguhet për shpifje, s'ka alternativë tjetër. Ai që t'i blen brekët edhe t'i heq sa herë të dojë vetë, ashtu edhe atij ia ka blerë brekët Serbia e ia heq sa herë të dojë, ndaj do ta hedhë vallen si duan serbët.

Ndërsa Hashim Thaçi dhe Ramush Haradinaj, ashtu siç kanë ditur ta çlirojnë Kosovën e ta krijojnë shtetin e popullit të tyre, do të dinë edhe ta mbrojnë nga mafia që e dëshirojnë shumë armiqtë e shqiptarëve e dhe nga shpifjet serbe e të zotëri Martyt, zëdhënësit më të fuqishëm të

Serbisë "demokratike" pas millosheviçiane.

"Familja Selimi, së bashku me familjen Lluka kontrollon kontrabandën e armëve, të drogës dhe automjeteve në zonën e Dukagjinit. Gjithashtu merret dhe me taksat ilegale të shqiptarëve si dhe me frikësimin e kundërshtarëve politikë. Janë të lidhur me Hashim Thaçin".<sup>4</sup> Siç shikohet, ashtu si edhe në raportin e zotit Marty, Hashim Thaçi kurrë nuk është marrë me asgjë tjetër veçse me koordinimin të kriminelëve dhe të rrjetave kriminale nëpër Kosovë, në trojet shqiptare, në Ballkan e në Evropë, bile në disa raste edhe në Amerikë. Shumë i zoti Hashim Thaçi. Mirë që nuk kanë shkruar se me ato para këta qeverisës të Kosovës i kanë bërë rrugët asfalt edhe nëpër bjeshkë. A ndoshta me këto para po i bëjnë edhe autostradat anembanë vendit të tyre. Ndoshta, pres të na e thotë Serbia e Dick Marty dhe Gjykata Speciale që po na i lodhë djemtë pa lidhje thonë pleqtë.

"Familja Kelmendi është në lidhje të ngushtë me Ramush Haradinajn dhe kontrollon kontrabandën e drogës e të naftës, tregtimin e njerëzve, si dhe pastrimin e parave në zonën e Pejës".<sup>5</sup>

Po Ramushi ku i përdorë gjithë ato para? Atij deri tani pas lufte pak i është lënë kohë të tregojë se sa shumë di të punojë për vendin e tij, siç ka treguar se sa shumë di të luftojë si luftëtar e komandant në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe që nuk i është lënë kohë, fajtorë janë Serbia dhe Dick Martat e Evropës që shpifin pa ndërprerje kundër tij, si edhe kundër të gjithë atyre të e pështynë Serbinë në surrat me gjithë potencialin masiv njerëzor e materialo - teknik luftarak që përdori kundër tyre.

"Familja Elshani merret me kontrabandën e armëve dhe të benzinës. Kontrollon zonën e Vitomircës dhe është e lidhur me Ekrem Llukën e Xhavit Halitin".<sup>6</sup>



<sup>1</sup> Obilić, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës Kosovare", "dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 31, botimi serbisht

<sup>2</sup> Obilić, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës Kosovare", "dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 31, botimi serbisht

<sup>3</sup> Obilić, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës Kosovare", "dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 31, botimi serbisht

<sup>4</sup> Obilić, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës Kosovare", "dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 31, botimi serbisht

<sup>5</sup> Po aty faqe 31

<sup>6</sup> Po aty faqe 31

# Libani dhe libanezët



**Shkruan: Xhabir HAMITI**

Në Liban për herë të parë zbrita në vitin 2002 për ta mbrojtur temën e magjistraturës. Gjatë studimeve në botën arabe shumë herë kisha dëgjuar gjëra interesante për Libanin, sidomos për multikulturalitetin dhe multikonfesionalitetin e tij, në veçanti për qytetin e Bejrutit i cili ndër arabët që moti njihej si Parisi i Lindjes së Mesme, mirëpo deri këtë herë asnjëherë nuk më ishte dhënë rasti ta vizitoja edhe fizikisht.

## Multikulturaliteti dhe multikonfesionaliteti libanez

Libani është një shtet, banorët e të cilit nga pjesët e tjera arabe dallohen me pasuri të shumta kulturore dhe me shumë antikitet të lashta historike. Ky shtet arab shtrihet në një pjesë gjeopolitike shumë të ndjeshme përgjatë detit Mesdhe. Kufizohet me Izraelin, Sirinë dhe Palestinën. Ndryshe, Libani është i njohur botërisht edhe për luftën e tij të gjatë dhe të përgjakshme qytetare mbi 25-vjeçare (1975-1990), gjurmët e së cilës në shumë pjesë të tij ende dukeshin të freskëta e të cilat të rikujtonin për një të kaluar të dhimbshme të kësaj shoqërie. Ky vend, në gjirin

e vet ka popullatën më multikonfesionale në Lindjen e Mesme. Rreth 50 për qind të libanezëve janë myslimanë të ndarë në dy orientime, 26 për qind suni dhe 24 për qind shia, kurse mbi 40 për qind e banorëve të tjerë janë të krishterë; ortodoksë, katolikë dhe protestantë, ndërsa rreth 5-6 për qind i takojnë sektit druzë. Gjatë lëvizjeve të mia në Lindjen e Mesme, në asnjë vend arab nuk kisha parë shoqëri më të fragmatizuar në aspektin e bindjeve fetare sesa në Liban. Një urrejtje e heshtur mbi bazën religjioze dhe atë sektare mbizotëronte thuajse kudo në mesin e kësaj shoqërie të vuajtur shumë nga lufta e gjatë qytetare. Dallimet më të theksuara shquheshin ato mes shiiteve të organizuar nën grupimin e tyre politik "Hizbu-llah" dhe sunive të cilët përafërsisht ishin të barabartë me numër të ihtarëve. Shiitët e Libanit vazhdimisht edhe tani mbështeteshin nga alevitët e pushtetit esedian në Siri si dhe nga autoritetet qeveritare të Iranit. Ende e kam të freskët fotografinë e myftiut libanez Hasan Halidit (1921-1989) të ekzekutuar përmes një atentati të përgatitur nga pjesa shiite ekstremiste e Libanit dhe Sirisë. Ndërhyrja e Sirisë në Liban përmes Hizbull-llahit ka qenë një problem i vazhdueshëm gjatë pesë dekadave të fundit, nga e cila ky vend ende nuk është liruar tërësisht. Përmes celulave të saj sekrete dhe konspirative Siria çdo herë ka qenë element destabilizues i Libanit. Regjimi esedian po ashtu është akuzuar nga i gjithë komuniteti ndërkombëtar për organizimin

dhe ekzekutimin e atentatit ndaj kryeministrit të suksesshëm libanez Refik el-Hairi, i cili në vitin 2005 në Bejrut, përmes një automjeti bombë të telekomanduar u vra në pabesi. Refiku u masakrua sepse ishte pjesëtar mysliman i drejtimit sunit. Kaq! Në Liban, siç edhe e përmenda më lartë jeton edhe komuniteti më i madh krishterë në Lindjen e Mesme. Gati në çdo pjesë të këtij vendi mund të shihje kisha dhe qendra tjera fetare të besimit të krishterë. Qyteti Xhuneh ishte njëri nga qytetet e bukura bregdetare, banorët e të cilit në shumicë absolute ishin të besimit krishterë. Partia e Hizbullahut, e udhëhequr nga sekretari i përgjithshëm Hasen Nasrallah, i njohur për lidhjet e tij shpirtërore dhe politike me Iranin, nga pjesa dërmuese e shoqërisë

libaneze shihej si një ndër faktorët kryesor destabilizues në vend.

## Tensionet e konfesioneve fetare në Liban, as tani nuk janë shuar tërësisht

Edhe pas përfundimit të luftës qytetare në vitin 1990, Libani për shkaqe sektare dhe politike ende vazhdon të jetë arenë e atentateve të herëpashershme vdekjeprurëse. Republika e Libanit ka një sistem interesant qeverisës, të bazuar mbi përkatësitë fetare të komuniteteve që jetojnë në të. -Kryetari i shtetit duhet të jetë i krishterë-maronit, -Kryeministri mysliman-sunit, -Kryetari i parlamentit mysliman-shiit, -Zëvendëskryeministri dhe

zëvendës kryetari i Parlamentit duhet të jenë pjesëtar të besimit krishterë maronit. Kjo duket se ishte formula e vetme e pajtimit mes fraksioneve, dhe si një kusht i vetëm për përfundimin e luftës së gjatë qytetare në këtë vend. Libani, gjegjësisht kryeqyteti i tij Bejruti, njihet edhe me emrin e Pashko Vas Shkodranit, i cili në këtë pjesë të Lindjes së Mesme ishte guvernator gjatë kohës së sundimit të Perandorisë Osmane, gjegjësisht nga viti 1883 deri në vitin 1892. Në Liban, Siri, Egjipt dhe Irak edhe sot mund të takosh numër të madh të familjeve me prejardhje shqiptare, të cilat në botën arabe në përgjithësi si dhe në Turqi njihen me emrin "Arnaut".

*(Shkëputur nga kujtimet e mia për Lindjen e Mesme)*



# A më me rëndësi është menaxhimi i pandemisë apo bisedimet me Serbinë?!



**Nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut**

Aktualisht Kosova, krahasuar për kokë banori, është në majat botërore për kah numri i të infektuarve dhe atyre që përfundojnë me fatalitet. Në vend se të kemi mobilizim të përgjithshëm për menaxhimin dhe tejkalimin e situatës e cila dita-ditës po përkeqësohet, inatet politike dhe përpjekjet për promovime dhe përfitime politike po ndikojnë dhe po e ndihmojnë përshkallëzimin e situatës. Në të gjitha mënyrat po pengohet votimi i Ligjit për

pandeminë, nuk ka gjë prej premtimit për programin për rimëkëmbje të ekonomisë në kohën kur shumica e bizneseve janë para ose të falimentuara. Shëndetësia, më parë shumë e lavdëruar, tash e kritikuar dhe jo mjaftueshëm e përkrahur nga shteti po i kalon vuajtjet e Tantalit dhe është buzë kolapsit përkundër përpjekjeve dhe sakrificave titanike të punëtorëve shëndetësor. Frika dhe apatia janë bërë shenjë dalluese e shumë qytetarëve të Kosovës. Po në këtë kohë kur po mendohet ekskluzivisht për mbijetesë, dikujt i është kujtuar ta ringjallë një koordinator për bisedime me Serbinë, sipas modelit dhe vullnetit të Borellit dhe Lajçakut, mohues të shtetit të Kosovës dhe shumë të afërt me Serbinë. Qetësuesi thuaja i vetëm dhe mashtruesi kryesor

për qytetarët e Kosovës, liberalizimi i vizave ka mbetur vetëm ëndërr, së paku deri më tani. Koordinator i për bisedime, i riinkarnuar, përveç ambicieve dhe premtimeve të mëdha për ta vendosur mbi kokë dafinën e fitores në këto bisedime, asgjë konkrete nuk ka ofruar dhe për asgjë nuk po i informon qytetarët e Kosovës sikur të vendosej për ardhmërinë e Tibetit e jo të Kosovës. Madje, i mbështjellë me një jotransparencë të madhe e bënë tërë këtë proces të dyshimtë, jo të besueshëm dhe me mundësi të përfundimit të keq për Kosovën. Kosova ka qenë e lodhur me 6 pikat e Ban Ki Munit për t'i përballuar 9 pikat e Lajçakut dhe Borellit të cilat nuk premtojnë asnjë të mirë për Kosovën përveç se hapin

rrugë Serbisë për integritet në BE-në në kohën kur Kosova është krejtësisht e izoluar pa një konsensus të domosdoshëm politik, të pozitës dhe opozitës, nuk mund të vazhdohet me bisedime të improvizuara, siç po veprohet tani. Nëse koordinatori Skender Hyseni nuk e ka përkrahjen e opozitës dhe subjektit i cili e ka caktuar në këtë pozitë, pa e marrë miratimin e spektrit të gjerë politik, atëherë nuk ka asnjë arsye të bëjë shpenzime të panevojshme. Ato mjete të shpenzuara krejtësisht kot, le të përdoren në luftë kundër pandemisë. Qytetarët e Kosovës kanë nevojë për ruajtje dhe mbrojtje të shëndetit, skajshmërisht të rrezikuar, për një gjendje ekonomike të përmirësuar dhe të

qëndrueshme, kthim në shkollë dhe normalizim të jetës e jo për bisedime të improvizuara, të dëmshme dhe të panevojshme për këtë kohë e që po bëhen për të siguruar një mbijetesë politike apo për t'u rikthyer nga arkivat e mbuluar me pluhur. Të drejtat e njeriut nuk sigurohen e as nuk mbrohen përmes këtyre bisedimeve të ricikluara por përmes forcimit të institucioneve dhe ligjit që do të ishin vendimtarë për menaxhimin dhe tejkalimin e situatës së shkaktuar nga Covid-19. Prandaj, KMDLNj ju thërrret t'i lini improvizimet dhe ambicjet personale, politike dhe partiake e të merreni me probleme reale me të cilën po përballen qytetarët e Kosovës dhe për të cilin edhe keni mandat! Deri më tani keni dështuar për përmbushjen e këtij mandati.



SABILE KEÇMEZI-BASHA

## SA PAK OKSIGJEN

## Sa pak oksigjen

Sa shumë sorollatje  
Për pak oksigjen  
Dhe për frymëmarrje  
Në stinën e djegur  
Në ecjen vertikale  
Në mëkatën e pabërë  
Në fushën me gaca shtruar  
Të minuar... nga ofkëllimat

Sa shumë lëngatë  
Dhe... harroje  
Pritjen në katakomb  
Dhe  
Harroje nusen  
Me fustan borali  
Të ngrirë në muranë  
Të përgjumur nga tymnaja  
Të skalpuar nga bisturia  
E brinjëve tua  
Imzot...  
Premtimin e dhënë  
Harroje  
Siç e kanë harruar  
Në një kohë tjetër  
... të paardhur  
Në një proces - katalizator  
Dëshmi

Pa argument  
Mos ma zë rrugën  
As mos ma vargëto yllin polar  
Se të kollofisnin katalanët

Eh...  
Të isha në një kohë tjetër  
Do të tregoja se si mund të jetohej  
Dhe të ta nxjerr nga vetja  
Krejt këtë tharm jete  
Dhe përsëri  
... përsëri  
Hurbat e tua  
Të kenë shije mjalti  
Në buzët e thekura

## Mos thuaj kurrë

Mos thuaj  
Se kurrë më  
Nuk do të kthehem  
Me kthimin bibliotekës  
Në tokën e djegur  
Se Liria ngeli depozitë  
e kohës shtatzënë  
Mbetë Ti ende në nisje  
Kur binte shi  
- kërpnajë

Mos thuaj  
Kurrë më... mallkuar qoftë  
Fjala e thënë... e pathënë  
Në ritakim  
Në rindarje

Përsëri  
Do të shihemi  
Ditën tjetër  
Kur nuk do të njihemi  
Dhembje

Më tregonin  
sa e kishin lënduar  
Tokën  
Shpirtin  
Shtatin

Merre me mend  
edhe dhembjen  
e kishin lënduar

Më thanë  
Pse e vrave pritjen  
Në Itakë  
Kur binte shi  
Sa tekanoze ishte stina  
A thua... të të pyes se  
Vetëm një stinë...

Dhe mbrëmë  
Penelopat u dëshpëruan  
Unë i pashë  
Me këta dy sy  
Duke i grisur këmishët  
Duke i djegur dalmatet e bardha

I pashë duke i shkullur flokët

Lotët si kokrra rrushi  
Në kupë i pinin – verë të kuqe  
Dhe ia hidhnin Olimpët në fytyrë

Penelopat janë mplakur  
Nga pritja e pritur  
Në udhëkryq motesh

## Fytyra

Kurrë nuk lakmova  
Një tjetër fytyrë  
Një tjetër botë  
Dhe një tjetër fat

Kurrë nuk desha  
Një tjetër vend  
Një tjetër stinë  
...  
Desha të kem  
Vetëm pak diell  
Pak ngrohtësi  
Pak liri  
Për vete  
Për nënë-Tokën  
Dhe për ata  
Që do të lindin

## Vjeshtë

Vjeshtë... tetor... ora njëzet  
Heshtja bën dialogun me mua  
Telefoni nuk bëzante  
Si ditëve të rëndomta

Jashtë rigon shi, përsëri shi  
Vjeshtë e lotuar në Prishtinë

Në univers zhvillohen betejat  
Ushtarët nga të dy anët bien  
Pa fitimtarë

Unë pres udhëtimin tej muzgut  
Të kohës së sëmurë  
Që zgjat me vite  
...  
Në tokën-Nënë

## Vikend i lodhur

Edhe ky vikend kaloi  
Duke bërë monolog  
Me kipcin tim karagjoz

Nëse inkarnohem ndonjëherë  
Përsëri do të doja  
Të takohem ma Karonin në vertikale

Dhe me këtë dhembje të përflakur  
Do të dëboj djajtë  
Nga planeti i UFO-ve

## Nga lashtësia

Në shuplakat e mia të djegur  
Hetoj portretin tënd fëmijëri  
Më vjen nga lashtësia me duvak të kuq  
E nuse pa dhëndër nuk deshe të bëhesh  
Lëkura e gjarprit në shuplakë më mbeti  
Dhe unë e di ku azilohet hidhërimi  
Dhe përsëri bëhem Doruntinë  
Mbi kalë të Konstandinit  
Duke të kërkuar nëpër mote

## Në samarin e historisë

As ti as unë nuk e mësuam dot historinë  
e tani duhet kuvenduar me varre të atdheut  
për të mësuar nga ADN-të e mbetura  
mbi gjeografinë e dhembjes

Do të më pyesësh  
Ç'kërkoj në skedarët e pluhurosor  
arkivorë  
Kur kurrë nuk pati dritë  
E dhembja migrenoze e harrimit  
Shteron kroin e pafund të kujtesës

Sot  
Ne jemi ushunjëza të kepit  
Mumies së panjohur do t'ia grisim  
maskën  
Historinë duhet mësuar me mur e  
muranë  
Kush të dojë le ta përsërisë emrin

## Ngushëllim

Dje nuk shkrova fare  
Malli përsëri lozi lojën  
Pa rregulla

Nesër  
Në kalldrëmin e lagur nga vesa  
do të ringjallet shtati i Atdheut  
Dhe në rrugët e Tiranës  
Do të më rikthehet kujtimi  
Në një trajtë krejt tjetër...

Dhe përsëri  
Erë molle të kuqe  
Do të ketë dita

Yllin polar  
E përfytyroja në anën tjetër të gjumit  
Tri herë kalova mbi urën e Siratit  
Flokët në litar u shndërruan


Dje nuk shkrova asgjë në ditar  
Ama asnjë fjalë për dritat që ikën  
As për telefonin që nuk bëzante  
Dhe matanë kufjes  
Më vështronin hijet  
Skelet nga lodhja

## Përsëri dhembja

Përsëri të njëjtat udhëkryqe i kalojmë  
Gumëzhitjet na zhbirojnë timpanin në  
mes stinëve  
Mërzia e dhembja lëshojnë shtat në  
sofër

Pëllëmbë për pëllëmbë i bie Tiranës  
Duke i ndjekur gjurmët e hijes në  
messtinë  
Liri, po të mos ishte ti  
Çfarë emri do t'i kishim vënë dhembjes  
o zot

Sonte përsëri qëndisa anatominë e  
dhembjes  
Ëndrrat e kuqe ma vijëzonin fatin  
Unë jam atje dhe pres apokalipsin  
Përgjoj kujdesshëm nëpër labirinte  
Ç'më dhemb largësia



# Letra e parë e Kurt Vonnegut-it për familjen pas daljes nga burgu

*Të dashurit e mi,*

Më treguan se ndoshta s'ju kanë informuar kurrë se s'kam qenë thjesht "i zhdukur". Ka gjasë po kështu që s'keni marrë asnjë nga letrat që kam shkruar në Gjermani. Kjo më detyron të shpjegoj shumë gjëra përmbledhtazi:

Kam qenë i burgosur lufte që nga 19 dhjetori 1944, kur divizioni ynë u bë fërtele nga nga goditja e fundit e dëshpëruar e Hitlerit përmes Luksemburgut dhe Belgjikës. Shtatë divizione të tërbuara tankesh goditën dhe na shkëputën nga pjesa tjetër e këmbësorisë së parë të Hodges. Divizionet e tjera amerikane në krahët tanë arritën të tërhiqen: ishim të detyruar të qëndronim dhe të luftonim. Bajonetat nuk janë edhe aq të mira kundër tankeve: municionet, ushqimi dhe furnizimet mjekësore na mbaruan dhe të plagosurit tanë e tejkalanuan numrin e atyre që ende mund të luftonin, prandaj hoqëm dorë. Divizioni 06 mori lëvdata nga Presidenti dhe një dekoratë britanike nga

Montgomery për këtë, por të flasim drejt, s'e meritonim. Jam ndër të paktët që s'u plagosa. Vetëm për këtë pjesë falënderoj Zotin.

E kështu, mbinjeriu na vuri të marshonim në rresht, pa ushqim, ujë apo gjumë deri në Limberg, afërsisht njëqind kilometra, ku u detyruam të hipnim dhe mbylleshim, në një makinë të vogël si kuti, të paajër dhe pa ngrohje, plot gjashtëdhjetë burra. Nuk kishte strehim hijenik, dyshemetë ishin të mbuluara me bajga të njoma lope. S'kishte vend për të gjithë të shtriheshim. Gjysma flinte ndërsa gjysma tjetër qëndronte në këmbë. Kemi kaluar disa ditë, edhe Krishtlindjet aty. Në prag të Krishtlindjeve, Forcat Ajrore Mbretërore bombarduan dhe qëlluan trenin tonë i cili s'kishte asnjë shenjë treguese. Vranë rreth njëqind e pesëdhjetë prej nesh. Na dhanë ujë ditën e Krishtlindjes dhe kaluam ngadalë nëpër Gjermani për të sosur në një kamp të madh për të burgosur lufte në Muhlburg, në jug të Berlinit. Na

nxorën nga automjetet ku të zihet fryma ditën e Vitit të Ri. Gjermanët na futën si kope nëpër dushe përvëluese për të na çmorritur. Shumë burra vdiqën nga shoku në dushe pas dhjetë ditësh urie, etje dhe kushtet e tmerrshme. Por jo unë.

Sipas Konventës së Gjenevës, Oficerët dhe Nën/Oficerët s'janë të detyruar të punojnë kur janë të burgosur. Unë jam, siç e dini, një ushtar. Njëqind e pesëdhjetë qenie të tilla të vogla u dërguan në një kamp pune në Dresden më 10 janar. Isha udhëheqësi i tyre për shkak të pak gjermanishtes që fola. Ishte fatkeqësia jonë që patëm roje sadiste dhe fanatike. Refuzuan të na japin ndihmë mjekësore dhe rroba. Na detyruan me dhjetra orë të bëjmë punë jashtëzakonisht të vështirë. Racioni ynë ushqimor ishte dyqind e pesëdhjetë gram bukë e zezë dhe një lugë supë patatesh çdo ditë. Pasi u përpoqëm të dëshpëruar ta përmirësojmë gjendjen tonë për dy muaj dhe pasi pashë se rojet

kishin ca buzëqeshje të çuditshme, u tregova atë që do të bëja me ta kur të vijnë rusët. Më rrahën pak. Më hoqën nga detyra si drejtues i grupit. Rrahjet s'merrnin shumë kohë: një djalë vdiq nga uria dhe trupat e SS qëlluan dy të tjerë se kishin vjedhur ushqim.

Diku afër 14 shkurtit erdhën amerikanët, të mbështetur nga Forcat e Armatosura Ajrore. Sulmi i tyre i kombinuar vrau 250.000 njerëz në njëzet e katër orë dhe shkatërroi të gjithë Dresdenin, ndoshta qyteti më i bukur në botë. Por jo mua. Pas kësaj u vunë në punë për të mbartur kufoma nga streha e sulmit kundër ajror: gra, fëmijë, pleq; të vdekur nga tronditja, zjarri ose mbytja. Civilët na mallkuan dhe na gjuajtën me gurë ndërsa bartnim trupa në turra të mëdha drush në qytet. Kur gjenerali Patton mori Leipzigun, u shpërngulëm në këmbë për në Hellexisdorf në kufirin Saksoni-Çekoslovak. Mbetëm aty derisa mbaroi lufta. Rojet na braktisën. Në atë ditë të lumtur, rusët kishin për

qëllim ta zhduknin atë rezistencë të izoluar, të jashtëligjshme në sektorin tonë. Avionët e tyre (P-39) na bombarduan, duke vrarë katërbëdhjetë vetë, por jo mua.

Tetë nga ne vodhën një qerre me dy mushka. Udhëtuaam dhe ikëm si hajdutë rrugës për në Sudetenland dhe Saksoni për tetë ditë, duke jetuar si mbretër. Rusët janë çmendur pas amerikanëve. Na morën me vete në Dresden. Nga atje shkuaam në frontin amerikan në Halle. Pastaj nga çuan me avion në Le Havre.

Po shkruaj nga një klub i Kryqit të Kuq në Le Havre për të burgosurit e luftës, kamp riatdhësi. Po më ushqejnë për mrekulli dhe po ia kaloj bukur shumë. Anijet shtetërore mbushen menjëherë, natyrisht, kështu duhet të jem i durueshëm. Shpresoj të jem në shtëpi brenda muajit. Pasi të kthehem në shtëpi, do të më japin njëzet e një ditë rehabilitimi në Atterbury, rreth 600 dollarë pagesë të prapambetur dhe, dëgjojeni pak këtë, gjashtëdhjetë (60) ditë leje!

Kam një mal me gjëra për t'u treguar, por e lëmë për më vonë. S'marr dot asnjë lloj poste këtu, kështu që mos më shkruani.

Ju përqafoj

Kurti

Shkëputur nga: "Kurt Vonnegut: Letra", Random House, 2012.

### Si të shkruash me stil

Reporterëve të gazetave dhe shkrimtarëve të letërsisë fantastiko-shkencore u është mësuar të mos zbulojnë gati asgjë për veten në shkrimet e tyre. Kjo i bën të çuditshëm në botën e shkrimtarëve, pasi pothuajse të gjithë të vobektët e ngjyer më bojë të asaj bote u zbulojnë shumë lexuesve për veten. Ne i shohim këto zbulesa si rastësore dhe të qëllimshme, elemente të stilit.

Këto zbulesa na tregojnë ne lexuesve se çfarë lloj personi është ai me të cilin po kalojmë kohën. A na duket shkrimtari i paditur apo i informuar, budalla apo mendjendritur, hileqar apo i sinqertë, pa humor apo lojçak? Dhe kështu me radhë. Pse duhet ta shqyrtoni stilin tuaj të shkrimit me idenë e përmirësimit të tij? Bëjeni si shenjë respekti për lexuesit çfarëdo që të shkruani. Nëse i hidhni mendimet shkel e shko ashtu si ju vijnë, lexuesit me siguri do të ndjejnë se nuk doni t'ia dini për ta. Ata do t'ju damkosin si delirant ose ose si mendjelehtë, ose, më keq, do të reshtin së

qeni lexuesi yt. Zbulesa më e mallkuar që mund të bëni për veten është se nuk e dini se çfarë është tërheqëse dhe çfarë nuk është. A nuk i pëlqeni ose nuk i pëlqeni ju vetë shkrimtarët më së shumti prej asa që ata zgjedhin t'ju tregojnë apo sepse ju fusin në mendime? A keni admiruar ndonjëherë ndonjë shkrimtar kokëbosh për mënyrën si e zotëron gjuhën? Jo. Kështu që stili juaj fitues duhet të fillojë me ide të mëdha që keni në kokë.

### Gjeni një subjekt që ju intereson

Gjeni një subjekt që ju intereson dhe që ju e ndjeni me zemër se u intereson edhe të tjerëve. Është ky kujdesi i vërtetë, dhe jo lojërat me gjuhën, që do të jetë elementi më bindës dhe joshës në stilin tuaj. Nuk po ju nxis të shkruani një roman, meqë ra fjala, megjithëse nuk do të më vijë keq nëse e keni shkruar, me kusht që të keni shkruar për diçka që vërtetë ju intereson. Një peticion për kryebashkiakun për një gropë para shtëpisë ose një letër dashurie për vajzën në lagje bën punë.

### Mos i bjer gjatë.

S'kam ndërmend t'i bie gjatë për ta theksuar këtë pikë.

Shkruaj thjesht

Për sa i përket përdorimit të gjuhës mos harroni se dy mjeshtër të mëdhenj të gjuhës,



Uiljam Shekspiri dhe Xhejms Xhojsi, shkruan fjali të cilat ishin gati fëmijore kur temat e tyre ishin më të thella. "Të rrosh a të mos rrosh?" – pyet Hamleti i Shekspirat. Fjala më e gjatë është tre shkronja. Xhojsi, kur ishte lojçak, mund të krijonte një fjali të ndërlikuar dhe të shkëlqyeshme si gjerdani i Kleopatërës, por fjalia ime e parapëlqyer në tregimin e tij "Evelina" është vetëm kjo: "Ajo ishte e lodhur." Në atë pikë të tregimit, asnjë fjalë tjetër nuk mund ta thyejë zemrën e lexuesit, siç e bëjnë këto tre fjalë. Thjeshtësia e gjuhës nuk është vetëm e vlerësuar, por ndoshta edhe e shenjtë. Bibla hapet me një fjali e cila brenda aftësive të shkrimit të një katërbëdhjetëvjeçari: "Në fillim Perëndia krijoi qiellin dhe tokën".

### Ki guximin të shkurtosh

Mund të ndodh që edhe ju të jeni të aftë të krijoni varëse për Kleopatërën, po ta themi kështu. Por gojëtarja juaj duhet të jetë shërbëtori i ideve që keni në kokë. Por rregulli juaj mund të jetë ky: Një fjali, sado e shkëlqyer qoftë, nëse nuk ndriçon temën tënde tuaj në ndonjë mënyrë të re dhe të dobishme, hiqeni.

### Ngjaji vetes

Stili i shkrimit i cili është mëse i natyrshëm për ju ka mundësi i bën jehonë ligjërimit që keni dëgjuar kur ishit fëmijë. Anglishtja ishte gjuha e tretë e romancierit Xhozef Konrad,

dhe shumë gjëra që dukeshin të shpejta në përdorimin e gjuhës angleze pa dyshim ishin të ngjyrosura nga gjuha e tij e parë, e cila ishte polake. Dhe është me të vërtetë me fat ai shkrimtari i cili u rrit në Irlandë, sepse anglishtja që flitet atje është kaq zbavitëse dhe muzikore. Unë vetë jam rritur në Indianapolis, ku e folura e zakonshme tingëlton si një sharrë që pret kallajin e galvanizuar, dhe përdor një fjalor të çrregullt si darë që shtrëngohet...

Unë vetë i besoj më së shumti shkrimeve të mia, dhe të tjerët duket se u besojnë gjithashtu, kur ngjaj me dikë nga Indianapolis-i, nga dhe jam. Çfarë alternativash kam? Ajo që rekomandohet më shumë nga mësimdhënësit, pa dyshim u është rekomanduar edhe juve: të shkruani si njerëz të kulturuar të para një shekulli apo më shumë.

### Thuaj pikërisht atë çfarë ke ndër mend të thuash

Ma sillnin në majë të hundës mësues të tillë, por jo më. Tani e kuptoj se të gjitha ato esë dhe tregime antike, me të cilat duhej ta krahasoja veprën time, nuk ishin të mrekullueshme për informacionin apo se ishin të huaja, por se thonin saktësisht atë çfarë kishin dashur të thoshnin autorët e tyre. Mësuesit e mi dëshironin që të shkruaja me saktësi, duke përzgjedhur gjithmonë fjalët në mënyrë të efektshme dhe duke i lidhur fjalët me njëra-tjetrën qartësisht, përpikmërisht, si bashkimi i

pjesëve të këmbimit të një makine.

Mësuesit në fund të fundit nuk deshën të më kthejnë në anglez. Shpresonin se do të bëhesha i kuptueshëm rrjedhimisht të më kuptonin. Dhe ja, pata atë ëndrën që të bëja me fjalët atë që Pablo Pikaso bëri me ngjyrat apo çfarëdo ishulli i khazit bëri me muzikën. Nëse thyeja të gjitha rregullat e pikësimit, u jepja fjalëve atë kuptim që doja unë të kishin, dhe nëse i lidhja së bashku në mënyrë të çrregullt, thjesht nuk do të kuptohej. Kështu që ju, gjithashtu, më mirë shmangeni stilin e Pikasos apo atë të khazit, nëse keni diçka që ia vlen ta thoni dhe doni të kuptoheni.

Lexuesit duan që faqet që lexojnë të duken shumë si faqet që kanë parë më parë. Pse? Kjo është për shkak se ata kanë një punë të vështirë për të bërë, dhe kanë nevojë për të gjithë ndihmën e mundur që mund t'u japim ne.

### Ki mëshirë për lexuesin

Lexuesit duhet të identifikojnë mijëra shenja të vogla në letër dhe t'ë nxjerrin kuptim prej tyre menjëherë. Ata duhet të lexojnë, një art kaq të vështirë sa shumica e njerëzve nuk e kuptojnë, edhe pasi i kanë studiuar në shkollë të mesme dhe të lartë, për dymbëdhjetë vjet të gjata.


Pra, në këtë diskutim duhet më në fund të pranohet se alternativat tona stilistike si shkrimtarë nuk janë as të shumta dhe as joshëse, pasi lexuesit tanë ka shumë gjasa të jenë artistë të tillë të papërsosur. Publiku ynë kërkon që ne të jemi mësues dashamirës dhe të durueshëm, gjithnjë të gatshëm për të thjeshtuar dhe sqaruar, ndërsa ne do të donim të fluturonim lart mbi turmën, duke kënduar si bilbila.

Ky është lajmi i keq. Lajm i mirë është se ne amerikanët qeverisemi nga një kushtetutë unike, e cila na lejon të shkruajmë çdo gjë që duam pa frikë nga ndëshkimi. Kështu, aspekti më kuptimplotë i stilit tonë, i cili është ajo që ne zgjedhim për të shkruar, është krejtësisht i pakufizuar.

### Për këshillë të vërtetë të detajuar

Për një diskutim të stilit letrar në një kuptim më të ngushtë, një kuptim më teknik, ju kërkoj t'i kushtoni vëmendjen tuaj librin "Elementet e stilit", nga Strunk, Jr. dhe E. B. White. E. B. White është, natyrisht, një nga stilistët më të admirueshëm letrar që ky vend ka nxjerrë deri tani. Duhet të kuptoni gjithashtu se askush nuk do ta vriste mendjen se sa mirë apo keq zoti White shprehet nëse nuk do të kishte për të thënë gjëra magjepsëse.

/Exlibris.al  
Përktheu: Granit Zela



E rrallë

## Fshatarët mbjellin 111 pemë sa herë që lind një vajzë



Në shumë pjesë të Indisë, foshnjat e gjinisë mashkullore favorizohen më shumë se vajzat, të cilat, për shkak të sistemit atje, mund të shihen si një barrë financiare për familjet. Por, njerëzit e fshatit Piplantri janë duke e luftuar këtë paragjykim. Aty fshatarët festojnë lindjen e vajzave të tyre duke mbjellë 111 pemë për secilën foshnje. Ritual i ka filluar pasi Shyam Sunder Paliwal ka humbur vajzën adoleshente dhe kishte mbjellë një pemë për nder të saj. Sot ai është duke udhëhequr kauzën për t'u siguruar që vajzat e Piplantri janë të mbrojtura nga lëndimet dhe të arsimuara në mënyrë që të rriten për t'u bërë të pavarura dhe të përmbushura me veten. Pemët tani janë duke u bërë burim i bukurisë, mirëmbajtjes dhe rritjes për vajzat dhe fshatin në tërësi.


### BARSOLETA E DITËS



**Biondina:** Mami, në shkollë u rrëzua një vajzë dhe të gjithë qeshën, përveç meje.  
**Mami:** Të lumtë bija ime! Po kush u rrëzua?  
**Biondina:** Unë.



### Në Kino ABC nuk ka shfaqje



### FOTO E DITES



Kjo fotografi tregon shkatërrimin që është shkaktuar në zonën e portit në Bejrut, pas shpërthimit të fuqishëm më 4 gusht. /AP/

E rrallë

## Shkencëtarët zbulojnë fenomenin e pashpjegueshëm që ndodh në sipërfaqen e diellit

Shkencëtarët kanë zbuluar një fenomen që ka ndodhur në sipërfaqen e diellit. Studiuesit në observatorin e Radios Metsahovi kanë gjetur zona të quajtura "ndriçime radio" në pjesë të shumta të diellit. "Burimet e tjera të përdorura nuk shpjegojnë shkakun e ndriçimit. Ne nuk e dimë se çfarë i shkakton ato fenomene. Ne duhet ta vazhdojmë studimin tonë", ka thënë shkencëtari Juha Kallunki. Studimi i minimumit diellor, periudha gjatë së cilës fusha magnetike e diellit është më e dobët, ka zbuluar edhe informacione të tjera të reja. Shkencëtarët më parë kanë besuar se sjellja e diellit gjatë këtyre minimeve ishte pasive dhe aq pak kërkime ishin bërë për veprimtarinë e yllit tonë më të afërt gjatë momenteve të tij më të qeta.

 <p><b>DASHI</b> Jeni shumë të ngarkuar dhe të lodhur. Në dashuri mund të ketë tensione dhe stres. Mundohuni që të flisni sa më qartë.</p>	 <p><b>DEMI</b> Çështjet ekonomike mund të jenë shkak për debatet në çift. Mundohuni që të planifikoni mirë gjërat që doni të bëni.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Keni nevojë për dikë me të cilin të flisni. Nga ana tjetër një miqësi mund të transformohet në diçka më shumë.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Ky është momenti i mirë për ndjenjat dhe dashurinë dhe tashmë gjërat do të varen nga ju. Kush po punon në këtë moment apo ka nisur projekte të reja, do të marrë rezultate pozitive.</p>	 <p><b>LUANI</b> Nëse dikush ju bezdis dhe nuk i vlerëson sforcimet tuaja, bëni mirë që ta injoroni. Kjo ditë është mjaft pozitive për punën, por ka gjëra të cilat duhen sqaruar.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Mos e shkarkoni në dashuri çdo tension të ditës, pasi mund të përkëqësoni situatën. Kjo periudhë është mjaft e mirë për punën, por dita mund të sjellë ndonjë shqetësim të vogël.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Kjo e mërkurë do të ofrojë emocione të bukura. Në punë dhe në çështjet ligjore, duhet të bëni kujdes të mos gaboni.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Në punë, mund të ketë zhvillime të reja dhe ndryshime. Bëni kujdes me sferën financiare, pasi mund të ketë probleme.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> E mërkura do të sjellë përmirësim si për dashurinë edhe për punën. Ky është momenti për të guxuar dhe rikthyer në lojë. Në punë, do të paraqiten mundësi të reja.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Do të jeni më pozitiv dhe humori paraqitet më mirë. Pavarësisht një sërë vështirësish, në punë gjërat do të ecin më mirë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Mundohuni që të jeni më të hapur me të tjerët. Ata që kanë një punë të tyre, parashikohen të njohin sukses.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Nëse në dashuri jeni përballur me vështirësi, duhet të mundoheni që të përmirësoni një raport. Në këtë moment mund të flisni dhe të zgjidhni problemet.</p>



## Kate Middleton vë maskë në publik për herë të parë



**K**ate Middleton është parë për herë të parë me maskë në një shoqatë për fëmijë. Dukeshja e Kembrixhit ka vizituar një bankë për fëmijë, ku ka ndihmuar punëtorët dhe ka folur me familjet që mbështeten në shërbim, shkruan "The Independent". Kate Middleton ka vazhduar punën

për mbështetjen e familjeve me një udhëtim në Baby Basics UK në Sheffield. Pas vizitave private në Baby Basics West Norfolk në fillim të këtij viti, ku Dukeshja kishte dëgjuar më shumë për nevojën e bankës për fëmijë për donacione, ajo ka dhuruar artikuj për foshnja nga markat dhe shitësit.

## Françeska Jaçe pozon krejt topless



**A**jo vazhdon të jetë një nga personazhet më të komentuar në faqet rozë falë fizikut atraktiv. Bëhet fjalë për Françeska Jaçen, e cila është mjaft aktive dhe ndiqet nga një numër i madh i njerëzve në rrjetet sociale. Në "Instagram" ajo numëron rreth 300 mijë ndjekës, ndërsa publikon

imazhe dhe video të llojllojshme, duke mos lënë anash as imazhet provokuese. Këtë e ka bërë edhe së fundi, ku ka pozuar krejt topless, ndërsa pjesët intime i ka mbuluar me duar. Ajo për publikun e gjerë është bërë më e njohur qysh nga pjesëmarrja në formatin e njohur televiziv "Big Brother".



## Kaq elegante ka kohë që s'e kemi parë Kejvinën

**K**ejvina Kthella është dukur mahnitëse në paraqitjen e radhës. Ai ka ndarë me ndjekësit një fotografi në "Instagram", në të cilën ka ardhur më ndryshe prej herëve të tjera. Kësaj radhe ajo është shfaqur e veshur me një fustan blu të gjatë, në

të cilin dukej tejet elegante, duke vënë në pah këmbën. Për këtë paraqitje, Kejvina ka pranuar komente të shumta nga ana e ndjekësve, të cilët e komplimentuan për dukjen. Javët e fundit Kejvina Kthella si shumë emra të tjerë ka publikuar një sërë fotografish në bikini.

## I dashuri ia qet në shitje të brendshmet, reagon modeluesja



**M**egan Barton Hanson ka pozuar në të brendshme derisa ka treguar se i dashuri i saj i ka shitur kilitat e saj për 200 dollarë. Ajo e ka akuzuar ish të dashurin e saj që ka shitur kilitat e saj pasi që në to kishte vënë datën e takimit të tyre. Ylli i Love Island (26) ka postuar një

mesazh në Story të "Instagramit", ku u ka thënë 1.7 milion ndjekësve që mos të bien pre e abuzimit të tij. Ish-stripistja ka thënë se ish i dashuri i saj ka vënë në diskutim marrëdhënien e tyre pas punës së saj në industrinë e seksit, pavarësisht se ai e dinte çfarë pune kishte bërë kur ata ishin takuar.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# FFK-ja kërkon nga Ministria e Shëndetësisë lejimin e fillimit të stërvitjeve

Drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës kanë kërkuar nga ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, që ta lejojë rifillimin e përgatitjeve në futboll. Zemaj ka konfirmuar se të premten do ta mbledhë këshillin për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe do ta konsultojë atë për të dhënë një vendim të shpejtë dhe të arsyeshëm



## "Epoka e re"

PRISHTINË, 5 SHTATOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, kanë takuar të mërkurën ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj. Drejtuesit e FFK-së kanë kërkuar nga ministri Zemaj lejimin e mbajtjes së stërvitjeve, pasi kampionati do të fillojë më 12 shtator. "Drejtuesit e FFK-së e njoftuan ministrin për situatën shëndetësore dhe nevojën për të filluar me stërvitje të gjitha

kategoritë e futbollit, nga shkollat e futbollit e deri te klubet e të gjitha ligave dhe rangjeve, përfshirë edhe futbollin e femrave dhe futsallin. Drejtuesit e FFK-së theksuan se është shumë e nevojshme që të fillojnë sa më parë stërvitjet përgatitore për kampionatin e ri ngaqë garat planifikohet të fillojnë më 12 shtator, kurse ka mbetur shumë pak kohë për ekipet", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Kanë mbetur vetëm edhe pesë javë para fillimit të kampionatit, që është kohë jo e mjaftueshme për fazën përgatitore. Gjatë këtij

takimi me theks të veçantë u diskutua për shkollat e futbollit dhe nevojën për të stërvitur që të mos stagnohet me zhvillimin e kategorive të reja. Sipas njoftimit, drejtuesit e FFK-së janë zotuar se do ta respektojnë protokollin strikt për shëndetin e futbollistëve. Në anën tjetër, ministri Zemaj ka thënë se të enjten do ta mbledhë këshillin për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe do t'i konsultojë ata për të dhënë një vendim të shpejtë dhe të arsyeshëm, duke pasur parasysh rëndësinë e stërvitjeve që futbollistët t'i mbajnë në formë.

## SHKURT

### Dushi, pas largimit nga Dukagjini: Shumë respekt dhe dashuri për qytetarët e Klinës

Jeton Dushi është larguar nga skuadra e Dukagjinit nga Klina. Dushi ka falënderuar kryesinë dhe futbollistët e Dukagjinit për korrektësinë e treguar gjatë kampionatit në rangun elitare. "Nuk jam më pjesë e Dukagjinit dhe jam futbollist i lirë. E falënderoj shumë drejtorin e klubit, Fabian Veselin, stafin e trajnerëve që punuam së bashku, po ashtu edhe shokët e skuadrës për mikpritjen që më dhuruan. I përshtes të gjithë qytetarët e Klinës, të cilët na mbështetën gjatë gjithë kampionatit. Shumë respekt dhe dashuri për ju", ka thënë Dushi, i cili në të kaluarën ka bërë karrierë edhe në klubin e Vëllaznimit nga Gjakova.

### Krasniqi largohet nga Flamurtari

Ashtu sikurse shumë futbollistë të tjerë, edhe Festim Krasniqi është larguar zyrtarisht nga skuadra e Flamurtarit. Klubi kuqezi ka rënë nga elita e futbollit të Kosovës dhe pas përfundimit të kampionatit nga kjo skuadër është larguar trajneri Sunaj Keçi dhe disa futbollistë. "Falënderoj Klubin KF Flamurtari për bashkëpunim, gjithashtu edhe bashkëlojtarët, stafin e trajnerëve, tifozët dhe zotëri Agim Hasanin. Nga sot do të jem lojtar i lirë, kurse klubit i dëshiroj rikthim sa më të shpejtë në Superligë", ka thënë Krasniqi.

### Feronikeli transferon edhe Ilir Avdylin

Portieri Ilir Avdyli gjatë është një tjetër futbollist që i është bashkuar FC Feronikelit për ta ndihmuar skuadrën drejt objektivave për sezonin 2020/21. Avdyli ishte pjesë e skuadrës së Kukësit nga Shqipëria dhe më parë ai kishte mbrojtur ngjyrat e KF Tiranës, KF Kamzës e, po ashtu, edhe Shkëndijës së Maqedonisë së Veriut. Kujtojmë se Avdyli ishte edhe pjesë e Kombëtares së Kosovës. Ilir Avdyli është i lindur më 20 maj 1990 në Prishtinë dhe është i gjatë 1.89 cm. Ai do t'i bashkohet klubit në stërvitje më 10 gusht.

### Troshupa transferohet në Poloni

Portieri Deniz Troshupa është larguar nga Feronikeli. Portieri, që ka edhe nënshtetësi të Polonisë, është kthyer në Poloni, ku ka nënshkruar kontratë me klubin e Stomil Olsztyn. Troshupa e ka bërë të ditur lajmin përmes një postimi në "Facebook". Ai ka nënshkruar kontratë me klubin polak dhe është prezantuar nga zyrtarët e Stomil Olsztyn në ambientet e klubit. Kjo skuadër aktualisht garon në kategorinë e dytë të futbollit polak. Në edicionin e kaluar Troshupa bëri vetëm 13 paraqitje në portën e skuadrës nga Drenasi.

## Katër vjet nga debutimi historik i Kosovës në Lojërat Olimpike

PRISHTINË, 5 GUSHT - Komiteti Olimpik i Kosovës e ka kujtuar parakalimin e sportistëve të Kosovës për herë të parë në ceremoni hapëse të Lojërave Olimpike, pikërisht katër vjet pasi Kosova shkroi histori me këtë debutim në

"RIO 2016". Kosova mori pjesë për herë të parë në Lojërat Olimpike në vitin 2016, në garat verore në Rio të Brazilit. Ekipi i Kosovës e mbylli debutimin në Lojërat Olimpike Rio 2016 me një medalje të artë,

të fituar nga Majlinda Kelmendi në kategorinë e peshave deri në 52 kilogramë në xhudo. "Sot katër vjet më parë ekipi Olimpik i Kosovës shkroi historinë duke parakaluar për herë të parë në ceremoninë hapëse të

Lojërave Olimpike", thuhet në postimin e Komitetit Olimpik të Kosovës. "Ekipi prej tetë sportistëve dhe trajnerëve me bajraktaren Majlinda Kelmendi, defiloj në stadiumin Marakana të Rios ku u hapën LO #Rio2016".



## Krasniqi: Kundërshtarët e mi janë ndihmuar nga palët e treta

PRISHTINË, 5 GUSHT - Boksieri Haxhi "Robin" Krasniqi ka thënë se disa prej meçeve i ka humbur vetëm pasi që kundërshtarët kanë marrë ndihma nga palët e treta në mënyrë të jashtëligjshme. Nga 55 meçet zyrtare, Krasniqi në

karrierën si boksier profesionist i ka fituar 49, 17 prej të cilave me nokaut, ndërsa i ka pësuar gjashtë disfata, një të me nokaut. Tani Krasniqi i ka paralajmëruar kundërshtarit e tij që, sipas tij, fituan në mënyra të jashtëligjshme, se

do të pësojnë gjithmonë nga ai. "Unë vërtet i kam humbur disa duele të boksit, ndër të tjera, edhe për shkak se palët e treta iu kanë ndihmuar kundërshtarëve të mi në mënyrë të jashtëligjshme, por thellë në zemër akoma nuk më

ka mposhtur askush dhe as nuk do të më mposhtë. Ata që tani e ndiejnë veten të përmendur, do të pësojnë gjithnjë ndaj meje. Këtë jua premtoj, sinqerisht", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e tij në "Facebook".



## Futbollistët e Dritës kryen testet për Covid-19 para udhëtimit në Zvicër

Kampionia e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, të shtunën me fillim nga ora 20:45 do ta zhvillojë ndeshjen e parë parakualifikuese për në Ligën e Kampionëve, kundër kampionit të Andorës, Inter Escalades

GJILAN, 5 GUSHT - Drita do ta përfaqësojë Kosovën në ndeshjet parakualifikuese të Ligës së Kampionëve që zhvillohen në Zvicër. Para nisjes për në Zvicër, për "KosovaPress" ka folur drejtori sportiv, Valon Zymberi, i cili ka bërë me dije se skuadra të premtën nisjet për në Zvicër dhe tanimë ka kryer testimet për Covid-19. "Po, i kemi kryer testet për Covid-19 dhe jemi në pritje të rezultateve. Të premtën do të udhëtojmë për në Nyon të Zvicrës", ka thënë Zymberi.



Për prurjet e reja në skuadër, Zymberi u shpreh se për në Ligën e Kampionëve ka përfunduar tashmë koha dhe nuk do të mund të regjistrojnë lojtarë të ri, ndërsa pas aventurës evropiane do të mblidhen me kryesinë dhe do

të diskutojnë për ndonjë transferim të mundshëm. "Para dy ditësh ka qenë dita e fundit për listën e lojtarëve. Ne e kemi dërguar atë. Lojtarët janë po ata që ishin në kampionat me të cilët u shpallëm kampionë. Pas Evropës do të shohim dhe, nëse është e mundur, do të bëjmë

ndonjë transferim", ka shtuar Zymberi. Drita të shtunën me fillim nga ora 20:45 do ta zhvillojë ndeshjen e parë parakualifikuese për në Ligën e Kampionëve, kundër kampionit të Andorës, Inter Escalades.

## Munishi: Prej sezonit të ri nuk flas për asgjë tjetër përpos për skuadrën time

SUHAREKË, 5 GUSHT - Ismet Munishi duket se e ka kuptuar që ofensiva e pakuptueshme me deklarata të përditshme gjatë pandemisë vetëm sa i bëri dëm Ballkanit, që prej pozitës së parë ra në të katërtën pas rifillimit të kampionatit, për ta mbyllur atë në vendin e tretë. Trajneri që bëri një punë të jashtëzakonshme gjatë edicionit 2019/20 te Ballkani, skuadër të cilën e bëri ekipin me futbollin më të mirë në vend, ka folur rreth sezonit të ri në një intervistë për "Sport Ekspres" në Shqipëri. Munishi ka deklaruar që prej sezonit të ri nuk do të flasë më për gjëra të tjera, por vetëm për ekipin.



"Nuk dua të kthehem te kjo pikë, por tani jemi në pikën e fillimit të sezonit dhe ekipet është më mirë që të investojnë dhe të bëjnë skuadra të mira që të kemi kompeticion të fortë sesa të investojnë në gjëra të tjera. Kjo është ajo që mendoj

unë dhe nuk dua të kthehem prapë për të folur rreth atyre gjërave që jam shprehur përgjatë kampionatit", ka deklaruar Munishi. "Besoj se kur i them disa gjëra në lidhje me fenomenin, atëherë i parandaloj ato, për këtë arsye edhe flas. Sidomos kur bëhet fjalë për arbitrimin. Por në sezonin tjetër absolutisht që

nuk do të merrem prapë me këto gjëra, do të merrem vetëm me ekipin tim, pjesa tjetër nuk më intereson", ka shtuar Munishi.

Më tutje, Munishi foli rreth të ardhmes së Blend Baftiut. "Skuadra e Ballkanit vazhdon të jetë perlë në kampionatin e Kosovës, një minierë ari. Kjo me lojën që ka treguar, por edhe mundësinë që ua ka dhënë lojtarëve të rinj", u shpreh Munishi. "Një prej tyre është edhe Baftiu që ka oferta shumë të mira dhe njerëz shumë seriozë që punojnë për të. Janë menaxherët Shkumbin Qormemeti dhe Haris Fakiç që merren me të. Të gjitha ekipet që kërkojnë Baftiun janë me histori shumë të madhe", ka shtuar ai.

Ballkani e ka nisur furishëm afatin kalimtar, duke transferuar Mevlan Zekën nga Feronikeli dhe Kenan Haxhihamzën nga Gjilani.

### SHKURT

#### Torino shënjestron Hysajn

Elsaid Hysaj ka rigjetur veten te Napoli. Trajneri Gennaro Gattuso i ka dhënë besim dhe shkodrani është përshtatur edhe në krahun e majtë, duke dhënë ndihmën e tij për ekipin. Gjithsesi zërat për largim është e pamundur të shmangen. Mario Giuffredi, menaxheri i tij, po punon për ta transferuar kapitenin e Shqipërisë. Torino është klubi që i ka hedhur sytë nga Hysaj, sipas asaj që shkruan "Tuttomercatoweb". Nga ana tjetër edhe Napoli po shikon për një tjetër mbrojtës. Giuffredi është ai që po punon për këtë lëvizje, pasi kërkon të çojë aty Davide Faraoni. Lojtari i Hellas Veronës menaxhohet nga menaxheri i shkodranit dhe ka zhvilluar një sezon fantastik në Serinë A, duke u cilësuar si një zbulim.

#### Ronaldo në janar kishte menduar të transferohet në PSG

Critiano Ronaldo ka menduar seriozisht të largohej nga Juventus në merkaton e dimrit, për këtë është e bindur "France Football". Sipas prestigjiozes franceze, Ronaldo ishte fiksuar pas idesë për t'u transferuar te PSG-ja pasi në sytë e tij bardhezinjtë nuk ishin klubi ideal për t'i arritur objektivat e tij. Dyshimet e CR7 erdhën fill pas fitores 2-1 kundër Lokomotivë Moskës në tetorin e shkuar, ylli portugez nuk ishte i zhgënjyer, por as i lumtur e për këtë arsye po mendonte të transferohej në një tjetër klub ku të kishte më shumë mundësi ta fitonte Ligën e Kampionëve. Në javët pasuese, gjithnjë sipas "France Football", Ronaldon po e joshte shumë ideja për t'u transferuar në Paris ku mund të formonte një sulm shpërthyes me Mbappe e Neymar. Ideja për t'u transferuar te PSG-ja u shua përfundimisht pas emergjencës që solli Covid-19.

#### Bonaventura largohet nga Milani, ky është mesazhi i tij

Pavarësisht prej sugjerimeve që i bëri Zlatan Ibrahimoviç Milanit, për ta rinovuar kontratën mesfushorit Giacomo Bonaventura, ky i fundit ka mbyllur përfundimisht aventurën me kuqezinjtë. Pas 6 sezoneve në të cilët ka shënuar në total edhe 35 gola me kuqezinjtë mes kampionatit, Kupës së Italisë dhe Kupave të Evropës, Jack Bonaventura është përhëndetur me Milanin pasi në fund të këtij sezoni i përfundoi edhe kontrata. Lamtumirën përfundimtare Milanit, Bonaventura ia ka dhënë me një postim në profilin e vet zyrtar në "Instagram". "Kam jetuar një ëndërr, vitet që kalova te Milani kanë qenë një përvojë e paharrueshme. Dua t'i falënderoj të gjithë personat me të cilët kam ndarë këtë aventurë të jashtëzakonshme", ka shkruar Bonaventura.

#### Bundesliga vendos për rikthimin e tifozëve

Bundesliga ka vendosur t'i lejojë tifozët të rikthehen në stadium që prej shtatorit, por pa praninë e tifozëve kundërshtarë. Federata e Futbollit në Gjermani ka vendosur t'i hapë dyert e stadiumeve për tifozët nëse qeveria jep dritën e gjelbër. Klubet e Bundesligës 2 votuan pro lejimit të tifozëve në stadium duke nisur nga shtatori. Gjithsesi presidenti i Federatës Gjermane të Futbollit, DFL, Kristian Siefert, paralajmëron se vendimi është në duart e politikanëve për shkak të krizës nga Covid-19. "Nëse dhe kur tifozët do të rikthehen në stadiume nuk është një vendim i DFL, por i politikanëve. Prioriteti nuk janë stadiumet plot, por shëndeti. Ne nuk duhet të marrim rreziqe të panevojshme, por duhet të jemi të kujdesshëm", deklaroi Siefert. Federata gjermane ka vendosur edhe disa rregulla për lejimin e tifozëve në stadiume si: jo tifozë kundërshtarë në stadiume deri në fund të 2020-s, jo alkoool në stadiume deri më 31 tetor, si dhe në hyrje të stadiumit do të mblidhen mjetet identifikuese të të gjithë tifozëve.



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN



www.uni-prizren.com

Prof. asoc. dr. Ismet Temaj

Nr. ref. 167

Data: 03/08/2020

Bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" nr. 04-V-621, Rregulloren nr. 01.111/A për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik si dhe vendimet nr. 01-162 dhe 01-166; Senati i Universitetit, shpall:

## KONKURS

PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIIMIN E PERSONELIT AKADEMIK<sup>1</sup>

### I. FAKULTETI I EKONOMISË

1. Një profesor (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Bazat e Marketingut (AB, MN), E-Marketingu (AB dhe MN), Tatimet dhe Vendimarrja (Ma).
2. Një profesor (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Mikroekonomi (AB dhe MN), Bazat e Financës, Analiza Financiare (Ma).
3. Një profesor (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Menaxhmenti Komunikues Ndërkulturor, Menaxhimi i Projekteve (AB dhe MN), Sjellja e Konsumatorit, Etika Profesionale (Ma).
4. Një profesor (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Organizimi i Ndërmarrjeve, Spss/Anova – Ekonometria, Makroekonomi (AB dhe MN).
5. Një profesor (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Etika në Biznes (AB dhe MN), Menaxhimi i Potencialëve Turistike dhe Analiza Financiare (AB dhe MN).

### II. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

1. Një mësime dhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Protokollet e Internetit (DS, sem. II, Z), Mësimi i Makinës (DS, sem. III, Z), Zhvillimi i Lojrave DS, sem. V, O), Finite Automata dhe Gjuhët Formale (TIT, sem. V, Z), Algoritmet e Selektuara (Maser sem. II, O), Tema të Zgjedhura nga Mësimi i Makinës dhe Inteligenca Artificiale (Master, sem. III, O).
2. Një mësime dhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Metodatat e Hulumtimit (TIT sem. IV, O), Metodatat Kërkimore (DS, sem. IV, O), Metodatat Empirike Kërkuese (Master sem. III, O), Inxhinieringu Softuerik dhe menaxhimi i Projekteve (DS sem. III, O), Dizajnimi i Sistemeve të Informacionit (DS sem. IV, Z), IT – Qeverisja (Master sem. III, Z).

### III. FAKULTETI JURIDIK

1. Një profesor (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: E Drejta Administrative (6 orë), Procedura Administrative (6 orë).

<sup>1</sup> Shprehjet e përdoruar në njërin gjini nënkuptojnë çdo herë edhe gjinin tjetër.

2. Një profesor (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: E Drejta e Procedurës Penale I (Pjesa e përgjithshme) (6 orë), E Drejta e Procedurës Penale II (Pjesa e posaqme) (6 orë).
3. Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët: E Drejta e Procedurës Penale I (Pjesa e përgjithshme) (6 orë), E Drejta e Procedurës Penale II (Pjesa e posaqme) (6 orë), Politika Kriminale, Penologjia, Klinika Penale, Informatika dhe Krimit Kompjuterike.

### IV. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në gjuhën mësimore shqipe:

1. Një mësime dhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Gjuhë shqipe I për Programin Parashkollor, Gjuhë Shqipe II për Programin Parashkollor.
2. Një mësime dhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Metodologji e gjuhës shqipe (Programi Fillor dhe Parashkollor); Strategjitë dhe metodatat e shkrimit leximit (Programi Fillor) me plotësim orësh në fakultetin e Filologjisë (Metodologji e gjuhës dhe Metodologji e letërsisë shqipe)
3. Një mësime dhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Matematika I për Programin Fillor, Matematika II për Programin Fillor; Matematika I për Programin Parashkollor; Matematika II për Programin Parashkollor.
4. Një asistent/te (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët: Matematika I për Programin Fillor, Matematika II për Programin Fillor; Matematika I për Programin Parashkollor; Matematika II për Programin Parashkollor, Metodologji e Mësimin të Matematikës I PF, Metodologji e Mësimin të Matematikës II PF.
5. Një mësime dhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Metodologji e Edukimit Fizik (Programi Fillor), Metodologji e Edukimit Fizik (Programi Parashkollor)

Në gjuhën mësimore turke:

1. Një mësime dhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Teoria e Mësimin: Praktika Pedagogjike II dhe III, Bazat e Hulumtimit në Edukim, Pedagogjia e Edukimit Parashkollor (Programi Fillor dhe Parashkollor).
2. Një mësime dhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Psikologji e Fëmijës (Programi Parashkollor); Hyrje në Psikologji (Programi Fillor); Hyrje në Psikologji (Programi Parashkollor); Psikologji e Edukimit (Programi Fillor).

Në gjuhën mësimore boshnjake:

1. Një mësime dhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Bazat e Shkencave Natyrore me Metodologji I (Programi Fillor); Edukimi Mjedisor (Programi Fillor); Bazat e Shkencave Natyrore me Metodologji (Programi Parashkollor); Edukimi Mjedisor (Programi Parashkollor).

### V. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe:

1. Një mësime dhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Kulturë Gjuhe, Shkrim Akademik, Leksikologji, Sociolinguistikë, Dialektologji e Gjuhës Shqipe, Gjuhësi Indoevropiane, Gjuhësi Ballkanike.
2. Një mësime dhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Letërsi Popullore, Letërsi e Vjetër Shqipe, Letërsi për Fëmijë, Letërsi Krahasimtare, Letërsi Botërore I, Letërsi e Sotme I, Letërsi Botërore II, Letërsi e Sotme II.

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze:

1. Një mësime dhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Fonetikë dhe Fonologji, Morfologji e Gjuhës Angleze, Anglishte për Qëllime të Veçanta I dhe II, Anglishte për Qëllime Akademike I dhe II.
2. Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët: Shkathësitë e Integruara II, Hyrje në Gjuhësi, Shkrim Akademik, Anglishte për Qëllime Akademike II, Anglishte për Qëllime të Veçanta I dhe II.

Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane:

1. Një mësime dhënë (avancim / riemërim në përputhje me nenin 172 përkatësisht 173 të Statutit) për lëndët: Gramatikë e Gjuhës Gjermane I, Morfologji e Gjuhës Gjermane, Hyrje në Didaktikën e Gjuhëve të Huaja, Metodika dhe Didaktika e Gjuhës Gjermane I, Metodika dhe Didaktika e Gjuhës Gjermane II, Seminari i Didaktikës.
2. Një mësime dhënë (në përputhje me nenin 173 të Statutit) për lëndët: Civilizimi dhe Kultura Gjermane I, Civilizimi dhe Kultura Gjermane II, Hyrje në Teknikën e Punës së Studimit të Gjermanistikës, Qytetërim Gjerman (DACHL) Komunikimi Ndërkulturor, Gjuhësi Gjermane I dhe II (Në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze).

### VI. FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT

1. Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i agrobiznesit: Projekte në Agrobiznes, BE-ja dhe Politikata e Përbashkëta Bujqësore, Ekonomiks, Çmimet dhe Tregjet e Produkteve Bujqësore, Ekonomia Bujqësore, Menaxhimi i Fermave, Menaxhim Agrobiznesi, Logjistikë e Avancuar në Agrobiznes.
2. Një asistent (në përputhje me nenin 174 të Statutit) për lëndët nga lëmi i biologjisë: Biologjia e Shtazëve, Biologjia e Bimëve, Gjenetika e Pyjeve, Ekologji e Bimëve dhe Gjeobotanikë, Sistematikë dhe Botanikë e Pyjeve, Mikrobiologjia Ekologjike dhe Monitorimi i Mjedisit.

### I. Kushtet dhe dokumentacioni për aplikim

1. Emërimi i personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren. Kandidatët të cilët aplikojnë për mësime dhënë duhet të kenë së paku gradën, *Doktor i Shkencave* (Dr. sc.), si dhe për pozitën e asistentit gradën *Master* ose *Magjistër* në fushën përkatëse.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për rizgjedhje asistent duhet të jenë të regjistruar në studimet e doktoratës, si dhe rizgjedhja e tyre bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 174 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti".
3. Dokumentacioni për aplikim:
  - Kërkesën dhe CV-në,
  - Kopjen e diplomës përkatëse (për pozitën e mësime dhënësi diploma e tri niveleve të studimeve; ndërsa për pozitën e asistentit dy nivelet e studimit edhe certifikatën e notave) të noterizuar;
  - Ekstraktin/certifikatën e lindjes (origjinale) dhe kopjen e letërnjoftimit;
  - Dëshminë nga gjykata mbi të kaluarën penale (origjinale);
  - Kandidatët të cilët janë të punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës duhet të paraqesin edhe vendimin për zgjedhjen e fundit si dhe raportin mbi vlerësimin e performancës (nëse aplikohet).
  - Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë;
  - Njohja e gjuhës angleze ose ndonjë gjuhë tjetër është përparësi për aplikantët.
4. Kandidatët që kanë doktoruar, magjistruar ose që kanë mbaruar master jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën do të konsiderohet e pakompletuar dosja e aplikantit.
5. Në rast se asnjëri prej kandidatëve nuk i plotëson kriteret ligjore për mësime dhënë apo asistent të shpallur sipas këtij konkursi, atëherë pozita e njëjtë mbetet e paplotësuar dhe procedura e konkursit do të mbyllet deri në rishpalljen eventuale të së njëjtës.

### II. Afati dhe mënyra e aplikimit

1. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në ueb-faqe, përkatësisht deri më datën 18.08.2020 në orën 15:00.
2. Paraqitja e dokumenteve bëhet në njësitë përkatëse akademike duke dorëzuar kopjen fizike si dhe të skanuara në CD, të njëjtën në kopje elektronike e dërgoni edhe në e-mail-in zyrtar: [apliko.upz@uni-prizren.com](mailto:apliko.upz@uni-prizren.com) (aplikacioni i dorëzuar vetëm në njërin mënyrë, fizike ose elektronike, nuk shqyrtohet nga komisioni).
3. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato që janë të pakompletuara apo të parregullta nuk do të pranohen në konkurs (nuk do të shqyrtohen nga komisioni përkatës).
4. Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen zyrtare në këtë adresë: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

### III. Procedura e zgjedhjes së kandidatëve dhe e drejta e ankesës

1. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve sipas këtij konkursi dhe e drejta e ankesës realizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" dhe dispozitat e rregullores nr. 01.111/A për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik (të cilën mund ta gjeni në faqen zyrtare: <https://uni-prizren.com>).

  
Rektor  
Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

[www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

Prof. asoc. dr. Ismet Temaj  
/ / /

Nr. ref. \_\_\_\_\_

Data: \_\_ -  
/ /

Na osnovu odredbi Statuta Univerziteta "Ukshin Hoti" br. 04-V-621, propis br. 01.111 / A o postupcima odabira u vezi sa imenovanjem, reizbor i izbor akademskog osoblja u naučno nastavna zvanja i odlukama br. 01-162 i 01-166; Senat univerziteta objavljuje:

## KONKURS

ZA IMENOVANJE, REIZBOR I IZBOR AKADEMSKOG OSOBLJA U NAUČNO NASTAVNA ZVANJA

### I. EKONOMSKI FAKULTET:

- Jedan profesor (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu s člankom 172. odnosno 173. statuta) za predmete:** Osnove marketinga (AB, MN), E-marketing (AB i MN), oporezivanje i odlučivanje (Ma).
- Jedan profesor (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu sa članom 172, odnosno 173 Statuta) za predmete:** Mikroekonomija (AB i MN), Osnove finansija, Finansijska analiza (Ma).
- Jedan profesor (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu sa članom 172, odnosno 173 Statuta) za predmete:** Međukulturalno komuniciranje, Upravljanje projektima (AB i MN), Ponašanje korisnika, Profesionalna etika (MA).
- Jedan profesor (u skladu s članom 173. statuta) za predmete:** Organizacija preduzeća, SPSS / Anova - ekonometrija, makroekonomija (AB i MN).
- Profesor (u skladu s članom 173. statuta) za predmete:** Poslovna etika (AB i MN), Upravljanje turističkim potencijalima i finansijska analiza (IA i MN).

### II. FAKULTET KOMPJUTERSKIH NAUKA:

- Jedan predavač (u skladu sa članom 173. statuta) za predmete:** Internet protokoli (SD, sem. II, i), Mašinsko učenje (SD, sem. III, i), Razvoj igara SD, sem. V, O), Finite Automata i formalni jezici (TIT, sem. V, i), Selektirani algoritmi ( Master sem. II, O), Odabrane teme iz mašinskog učenja i veštačke inteligencije (master, sem. III, O).
- Jedan predavač (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu sa članom 172, odnosno 173 statuta) za predmete:** Metode istraživanja (TIT sem. IV, O), Istraživačke metode (SD, sem. IV, O), Empirijske metode istraživanja (Master sem. III, O), Softverski inženjering i upravljanje projektima (SD sem. III, O), Dizajn informacionih sistema (SD sem. IV, i), IT – Upravljanje (master sem. III, i).

### III. PRAVNI FAKULTET:

- Jedan profesor (u skladu sa članom 173. statuta) za predmete:** Administrativno pravo (6 časa), Administrativna procedura (6 časa).
- Jedan profesor (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu sa članom 172, odnosno 173 statuta) za predmete:** Zakon o krivičnom postupku I (opšti dio) (6 časa), Zakon o krivičnom postupku II (poseban deo) (6 časa).
- Asistent (u skladu sa članom 174. statuta) za predmete:** Zakon o krivičnom postupku I (opšti deo) (6 časa), Zakon o krivičnom postupku II (Posebni deo) (6 časa), Krivična politika, Penologija, kriminalistička klinika, informatika i kompjuterski zločin.

### IV. EDUKATIVNI FAKULTET

#### Na albanskom jeziku:

- Jedan predavač (u skladu sa članom 173. statuta) za predmete:** Albanski jezik I za Predškolski program, Albanski jezik II za Predškolski program.
- Jedan predavač (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu sa članom 172, odnosno 173 statuta) za predmete:** Metodologija albanskog jezika (osnovni i predškolski program); Strategije i metode pisanja i čitanja (osnovni program) sa dopunom časova na Filološkom fakultetu (Metodologija jezika i Metodologija albanske književnosti)
- Jedan predavač izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu s člankom 172. odnosno 173. statuta) za predmete:** Matematika I za osnovni program, Matematika II za osnovni program; Matematika I za Predškolski program; Matematika II za Predškolski program.
- Jedan asistent (u skladu sa članom 174. statuta) za predmete:** matematika I za osnovni program, matematika II za osnovni program; Matematika I za Predškolski program; Matematika II za Predškolski program, Metodologija nastave matematike I OP, Metodologija nastave matematike II OP.
- Jedan predavač (u skladu sa članom 173. statuta) za predmete:** Metodologija fizičkog vaspitanja (Osnovni program), Metodologija fizičkog vaspitanja (Predškolski program)

#### Na turskom jeziku:

- Jedan predavač (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu s člankom 172. odnosno 173. statuta) za predmete:** Teorija učenja; Pedagoška praksa II i III, Osnove istraživanja u obrazovanju, Pedagogija predškolskog obrazovanja (Osnovni i Predškolski program).
- Jedan predavač (u skladu sa članom 173. statuta) za predmete:** Dječija psihologija (Predškolski program); Uvod u psihologiju (Osnovni program); Uvod u psihologiju (Predškolski program); Psihologija obrazovanja (Osnovni program).

#### Na bosanskom jeziku:

- Jedan predavač (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu s člankom 172. odnosno 173. statuta) za predmete:** Osnove prirodnih nauka sa metodologijom I (osnovni program); Obrazovanje za zaštitu životne sredine (Osnovni program); Osnove prirodnih nauka sa metodologijom (Predškolski program); Obrazovanje za zaštitu životne sredine (Predškolski program).

### V. FILOLOSKI FAKULTET

#### Studijski program- albanski jezik i književnosti

- Jedan predavač (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu sa članovima 172 i 173 Statuta) za predmete:** Jezička kultura, Akademsko pisanje, Leksikologija, Sociolingvistika, Dijalektologija albanskog jezika, Indoevropska lingvistika, Balkanska lingvistika.
- Jedan predavač (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu sa članovima 172 i 173 Statuta) za predmete:** Narodna književnost, Stara albanska književnost, Dječja književnost, Usporedna književnost, Svjetska književnost I, Savremena književnost I, Svjetska književnost II, Savremena književnost II.

#### Studijski program engleski jezik i književnost

- Jedan predavač (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu sa članovima 172 i 173 Statuta) za predmete:** Fonetika i Fonologija, Morfologija engleskog jezika, Engleski za posebne namjene I i II, Engleski za akademske namjene I i II.
- Jedan asistent (u skladu sa članom 173. statuta) za predmete:** Integrirane vještine II, Uvod u lingvistiku, akademsko pisanje, engleski za akademske svrhe II, Engleski s posebnom namjenom I i II.

#### Studijski program- Njemački jezik i književnosti

- Jedan predavač (izbor u akademsko zvanje / reizbor u skladu sa članovima 172 i 173 Statuta) za predmete:** Gramatika njemačkog jezika I, Morfologija njemačkog jezika, Uvod u didaktiku stranih jezika, Metodika i didaktika njemačkog jezika I, Metodika i didaktika njemačkog jezika II, Seminar i didaktike.
- Jedan predavač (u skladu sa članom 173. statuta) za predmete:** Njemačka kultura i civilizacija I, Njemačka kultura i civilizacija II, Uvod u radnu tehniku izučavanja njemačkih studija, Njemačka civilizacija (DACHL) Interkulturalna komunikacija, Njemački jezik I i II (Studijskog programa, Engleski jezik i književnosti).

### FAKULTET ŽIVOTNIH I OKOLIŠNIH NAUKA

- Asistent (u skladu s člankom 174. statuta) za predmete iz oblasti agrobiznisa:** Agrobiznis projekti, EU i zajedničke poljoprivredne politike, Ekonomija, Cijene i tržišta poljoprivrednih proizvoda, Poljoprivredna ekonomija, Upravljanje poljoprivredom, Uprava agrobiznisa, Napredna logistika u agrobiznisu.
- Asistent (u skladu s člankom 174. statuta) za predmete iz područja biologije:** Biologija životinja, Biologija bilja, Šumska genetika, Ekologija bilja i geobotanika, Sistematika i botanika šuma, Ekološka mikrobiologija i monitoring životne sredine.

### I. Uslovi i dokumentacija za prijavu

- Imenovanje akademskog osoblja vršice se u skladu s odredbama Statuta Univerziteta "Ukshin Hoti" u Prizrenu. Kandidati za nastavnike treba da imaju najmanje stepen doktora nauka (Dr. sc.), dok za asistente stepen MSc. ili magistar u relevantnoj oblasti.
- Podnosioci zahtjeva koji se prijavljuju za reizbor na mesto asistenta moraju biti upisani na doktorskim studijama, u skladu sa odredbama člana 174 Statuta Univerziteta "Ukshin Hoti" (I tačka 4)
- Dokumenta za apliciranje:**
  - Zahtjev i CV,
  - Kopija odgovarajuće diplome (za poziciju predavača diploma tri nivoa studija; dok za poziciju asistenta dva nivoa studija i certifikat ocjena) ovjereni kod notara.
  - Ekstrakt/izvod rođenih (original) i kopija lične karte;
  - Potvrda da nisu osuđivani za krivična djela (original);
  - Kandidati koji su zaposleni u bilo kojoj visokoškolskoj ustanovi u Republici Kosovo trebaju dostaviti konačnu odluku o izboru u zvanju i izvještaj o ocjenjivanju rada (ako je primjenljivo).
  - Dokaz o naučnim i stručnim publikacijama, kao i druge posebne dodatne informacije, koje su relevantne za one koji se prijavljuju;
  - Poznavanje engleskog ili bilo kojeg drugog jezika prednost je za podnosioca zahtjeva.
- Kandidati koji su doktorirali, magistrirali ili su završili master studije u inostranstvu, trebaju dostaviti i nostrifikaciju odgovarajuće diplome iz MONT-a, u suprotnom dosije podnosioca zahtjeva smatraće se nepotpunim.
- Ukoliko nijedan od kandidata ne ispunjava zakonske kriterijume za nastavnika ili asistenta koji su naznačeni u ovom konkursu, pozicija ostaje nepopunjena, a postupak za izbor će biti zatvoren ili će se konkurs ponoviti.

### I. Rok i način apliciranja

- Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama i na web stranici, odnosno do 18.08.2020 u 15:00.
- Podnošenje dokumenata se vrši u odgovarajućim akademskim jedinicama (podnošenjem fizičke kopije i skeniranjem na CD-u,) i elektronskoj kopiji na službenom e-mailu: [apliko.upz@uni-prizren.com](mailto:apliko.upz@uni-prizren.com) (aplikacije koje pristignu samo putem elektronske pošte neće biti razmatrane od strane relevantne komisije).
- Prijave primljene nakon isteka roka i one koje su nepotpune ili nepravilne neće biti prihvaćene u konkursu (neće ih razmatrati nadležna komisija).
- Konkurs se takođe može naći na službenoj web stranici: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

### III. Postupak odabira kandidata i pravo na žalbu

- Postupak odabira kandidata prema ovom konkursu i pravo na žalbu ostvaruju se u skladu sa važećim zakonskim odredbama, odredbama Statuta Univerziteta "Ukshin Hoti" i odredbama Uredbe br. 01.111 / A o postupcima odabira u vezi sa izborom, reizborm i za izbor akademskog osoblja u naučno nastavna zvanja (koji se mogu naći na službenom web-u: <https://uni-prizren.com>).



Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/653

Më: 05.08.2020

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

## KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

Viti shkollor 2020/2021

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU" 18 Prilli" në Burim	Mësim klasorë	Zëvendësim i lehonisë	1	20
2	SHFMU" Emin Duraku" në Dragobil	Mësim klasorë	Zëvendësim i lehonisë	1	20

### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)
- certifikata e lindjes

### II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr 04/L-032 dhe , Ligji Nr. 03/L-068) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr 10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës program fillor kërkohet kualifikimet: **Fakulteti i Edukimit- programi fillor; Fakulteti i Mësuesisë** ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

**III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.**

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

SQARIM: Kandidatët mund të konkurrojnë në më shumë shkolla, por me dokumente të veçanta.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

**Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.**

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe testit me gojë sipas nenit 10 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ nr. Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web- faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

### Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **05.08.2020 deri më datën:19.08.2020**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.



An EU Funded Project  
Managed by the EU Office in Kosovo



Implemented by Hit Flores ShPK

## Contract Title: Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels

### Publication Reference: 1-2019/413-249

05 August 2020

Hit Flores Sh.P.K, with the address: Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo, intends to award the contract for: **Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels.**

All interested and qualified bidders, national and international, are invited to apply. The tender dossier is available from [hit\\_flores@hotmail.com](mailto:hit_flores@hotmail.com)

The deadline for submission of bids is: **05 September 2020 at 15:00 hours local time** at the following address: Hit Flores Sh.P.K, Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ramit Kukaj shpall te pavlefshme diplomen shme " Ymer Prizreni " Prizren

► Senada Abdi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf " Leke Dugagjini " Prizren

► Drenusha Xhemajliu shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shf " Faik Kornica " Celine

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

**Ziraat Bank** TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE**Bilanci i gjendjes me : 30.06.2020** Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
<b>Pasurite</b>		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BC	7,754.78	7,187.10
Kërkesat ndaj bankave	479.93	711.28
Bonot e thesarit		
Investimet në letra me vlerë	6,943.07	7,000.86
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	46,714.37	48,328.37
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,314.94	1,232.57
Pasuritë e paprekshme	228.36	215.34
Pasuritë tatimore të shtyra	187.02	187.02
Pasuritë tjera	33.54	155.59
<b>Gjithsej pasuritë</b>	<b>63,656.01</b>	<b>65,018.12</b>
<b>Detyrimet</b>		
Depozitat e klientëve	44,995.01	43,899.14
Detyrimet ndaj bankave	4,107.88	6,186.88
Fondet tjera të huazuara	5,504.28	5,500.31
Detyrimet tatimore të shtyra		
Detyrimet tjera	693.15	978.57
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<b>55,300.31</b>	<b>56,564.89</b>
<b>Ekuiteti i aksionarëve</b>		
Kapitali aksionar	10,000.00	10,000.00
Rezervat e kapitalit		
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet p-	2,177.05	2,177.05
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	368.27	465.80
Përbërësit tjerë të ekuitetit	164.47	164.47
<b>Gjithsej ekuiteti i aksiona</b>	<b>8,355.69</b>	<b>8,453.23</b>
<b>Gjithsej detyrimet dhe e</b>	<b>63,656.01</b>	<b>65,018.12</b>



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Ziraat Bank** TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE**Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 30.06.2020** Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	744.00	1,558.78
Shpenzimet e interesit	219.85	506.23
<b>Neto të hyrat nga interesi</b>	<b>524.15</b>	<b>1,052.55</b>
Të hyrat nga tarifatat dhe komisionet	239.04	368.06
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	36.68	81.17
<b>Neto të hyrat nga tarifatat dhe komisionet</b>	<b>202.35</b>	<b>286.89</b>
Neto të hyrat nga tregtimi	2.27	6.83
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	1.51	1.69
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	413.12	822.77
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>317.17</b>	<b>525.19</b>
Provizionet për humbjet nga kreditë	43.83	56.81
Provizionet tjera	7.28	2.58
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	<b>368.27</b>	<b>465.80</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
<b>Fitimi/(humbja) neto</b>	<b>368.27</b>	<b>465.80</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
<b>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>368.27</b>	<b>465.80</b>

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola

Columbus, Georgia, USA  
Since 1905

Columbus, Georgia, USA  
0.5L